



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 KORRIK 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 15.
JULA 2008. GODINE

KORRIK – JULI

2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për punën,
6. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes të Ligjit për sigurimin shëndetësor,
7. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës.

Dnevni red:

1. Usvajanje zapisnika plenarne sednice održane dana 30. juna 2008.godine,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona o privatnoj bezbednosti,
4. Razmatranje Preporuke Komisije za javne službe, lokalnu administraciju i medije, u vezi zahteva Vlade o povlačenju iz procedure razmatranja Nacrta zakona o službenim statistikama Republike Kosova,
5. Razmatranje Preporuke Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje, u vezi zahteva Vlade o povlačenju iz procedure razmatranja Nacrta zakona o radu,
6. Razmatranje Preporuke Komisije za zdravstvo, rad i socijalno staranje, u vezi zahteva Vlade o povlačenju iz procedure objavljivanja Zakona o zdravstvenom osiguranju,
7. Razmatranje Izveštaja sa preporukama Komisije za zakonodavstvo i sudstvo o izboru članova Komisije za polaganje pravosudnog ispita.

A g e n d a

1. Approval of the minutes of plenary session held on 30 June 2008,
2. Time for parliamentary questions,
3. Second reading of the Draft law on Private Security,
4. Review of recommendation made by Committee on Public Services, Local Administration and Media regarding the request of the Government on withdrawing from review procedure the Draft law on Official Statistics of Republic of Kosovo,
5. Review of recommendation made by Committee on Health, Labour and Social

- Welfare regarding the request of the Government on withdrawing from review procedure the Draft law on Labour,
6. Review of recommendation made by Committee on Health, Labour and Social Welfare regarding the request of the Government on withdrawing from promulgation procedure the Law on Health Insurance,
 7. Review of the report with recommendations of the Committee on Legislation and Judicial in selecting members of the Committee for bar examination.
-

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup KRASNIQI**.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra, mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka parashtruar për shqyrtim dhe miratim Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Propozim-vendimi i Qeverisë, së bashku me autobiografinë e kandidatëve, u është shpërndarë deputetëve.

Nëse nuk ka vërejtje nga shefat e grupeve parlamentare, kërkoj deklarin e seancës plenare që me votim formal të plotësohet rendi i ditës.

Po përsëris, fjalën mund ta marrin shefat e grupeve parlamentare.
Fjalën e ka Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të respektuar anëtarë të Qeverisë, ministra,
Zoti Kryetar, ne menduam se do të ishte mirë të deklarohet me votë formale Kuvendi, por ne jemi për këtë shtim të rendit të ditës. Faleminderit!
KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Natyrisht, Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet propozimin. Njëkohësisht, me kërkesë të ministres së Drejtësisë, zonjës Nekibe Kelmendi, kërkohet një ndryshim i rendit të ditës. Po ashtu, iu kisha lutur që t'ia jepni mundësinë asaj që ta arsyetojë në emër të saj mocionin e LDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare. Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së pajtohet me këtë rend të ditës, natyrisht me një sqarim pak më të gjerë të kërkesës së Qeverisë për Bordin e Agjencisë Kosovare për Privatizim, ngase në këtë kërkesë të Qeverisë kemi dy anëtarë nga Sindikata, që është në kundërshtim me Ligjin për Agjencionin Kosovar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se nuk duhet të futet kjo pikë në rend të ditës dhe, po ashtu, mendon se duhet që komisioni parlamentar, i cili ka të bëjë me këtë temë, ta japë mendimin e vet për Grupin Parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së e ka fjalën Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne u konsultuam shumë shkurt dhe mendojmë se është absolutisht e panevojshme, në këtë formë, të futet kjo pikë e rendit të ditës. Mendojmë se duhet një përgatitje më e mirë dhe një analizë nga deputetët, në mënyrë që të jemi të përgatitur për të vendosur drejt lidhur me këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar “7+” Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne të Grupit Parlamentar “7+” jemi për këtë listë që e kemi për rendin e ditës dhe mund të punojmë me të.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, fjalën e ka deputeti Sllobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

U ime Poslaničkog kluba Samostalne Liberalne Stranke, kažem da se slažemo sa dopunom dnevnog reda.

KRYETARI: Faleminderit! Driton ende nuk kemi hyrë në shqyrtimin e rendit të ditës. Kur të arrijmë aty, mund ta marrësh fjalën.

Lus ministren, zonjën Nekibe Kelmendi, ta bëjë mocionin.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Ministria e Drejtësisë i ka propozuar Kuvendit një listë të kandidatëve për Komisionin për provimin e jurisprudence.

KRYETARI: Ministre, tani jemi në rendin e ditës dhe kur të vijmë aty, do ta merrni fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Pikërisht, për atë e kam fjalën. Meqë lista e Ministrisë së Drejtësisë është ndryshuar nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi...

KRYETARI: Tash jemi për këtë pikën e parë që ta përfundojmë e pastaj kalojmë...

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Atëherë, po i bie më shkurt! Po e tërheq këtë propozimin tim prej rendit të ditës për Komisionin për provim të jurisprudencës.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Të shkojmë sipas rendit. Tani do të votojmë.

Kush është për t'u futur në rend dite propozimi i Qeverisë për propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Po, kemi të bëjmë me një votim formal.

Kush është “për”? Faleminderit!

Kush është “kundër”? Le të numërohen votat, ju lutem! Faleminderit!

A ka abstenim?

Konstatoj se “për” kanë votuar 44 deputetë, “kundër” 12, kurse 5 kanë abstenuar kështu që hyn në rend të ditës propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Ju faleminderit!

Tani, radha është për kërkesën e ministres së Drejtësisë, zonjës Nekibe Kelmendi, për ta hequr nga rendi i ditës pikën 7.

A donë shefat e grupeve parlamentare të deklarohen për këtë çështje?

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Kërkesën e ministres, që është anëtare e Kabinetit qeveritar, sot e kemi diskutuar, e ka paraqitur arsyetimin, për çka u mundua, po ashtu, këtu t'i bindë kryesuesin dhe Kryetarin e Kuvendit. Ne e kemi mbështetur në parim dhe mendojmë që duhet të jetë një koordinim më i mirë ndërmjet ministres dhe organeve të tjera që të funksionalizohet kjo pjesë e punës sonë. Mendoj se më shumë kemi të bëjmë me shtyrje të rendit të ditës për t'u ristrukturuar përmes një koordinimi më të mirë. Këtu është edhe kryetari i komisionit funksional që ka punuar aktivisht, zoti Bahri Hyseni dhe mendoj se ai mund ta marrë fjalën lidhur me këtë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje, të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në nenin 65 pika 14 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në nenet 6.2 dhe 7.6 të Ligjit për provimin e jurisprudencës, në pajtim me Rregullën 46 pika 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës,

ka shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, të dorëzuar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi më 6 maj dhe, pas shqyrtimit të kandidatëve të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, duke u bazuar në kompetencat e Komisionit dhe në Ligjin për provimin e judikaturës, ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë sqarime për kandidatët e propozuar.

Pas sqarimeve që i kemi marrë nga Ministria e Drejtësisë dhe pas propozimeve shtesë që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, pas shqyrtimit të hollësishëm të çështjes përkritazi me propozim-vendimin e lartcekur dhe të propozimeve për ndryshimin e tij, në mënyrë unanime ka vendosur që të ndryshojë pikën 3 të propozimit të Ministrisë së Drejtësisë, duke u bazuar në Ligjin aktual për provimin e judikaturës.

Arsyet kanë të bëjnë jo me emrat e propozuar, por për shkak të eksperiencës që është kërkuar me ligj dhe për kandidatin Ruzhdi Berisha, i propozuar që të jetë pyetës i lëndës trashëgimore, familjare dhe të gjitha lëndëve civile për provimin e juridikaturës, edhe pas sqarimit shtesë, si komision nuk kemi ardhur në përfundim të marrim opinione të qarta se a i plotëson kriteret të jetë kandidat pyetës i lëndës për arsye se nuk kemi konstatuar që ai ka përvojë dhjetëvjeçare pa ndërprerë në lëndën përkatëse. Këtu ka qenë defekti.

Ne kemi kuptuar se zoti Ruzhdi Berisha ka përvojë të mjaftueshme profesionale, sepse ka ndryshuar për çdo vit vendin e punës, duke kaluar herë kryetar i Gjykatës në Dragash, herë gjyqtar i Gjykatës Supreme, herë avokat, mirëpo decidivisht nuk kemi mund të gjejmë dhe nuk ka sqarime nga propozimi i Ministrisë së Drejtësisë se ai ka punuar në çështjet civile. Pra, nuk kemi sqarim.

Ne i jemi drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe nga sqarimet që na kanë ardhur nuk kemi pasur sqarim. Shpresoj se këtë raport e keni.

Prandaj, duke u bazuar në Ligjin për provimin e judikaturës, në nenin 7.6 thuhet qartë: “Me vendim për emërimin e Komisionit do të caktohet se në cilat lëndë do të pyes kryetari i Komisionit dhe cilat lëndë anëtarët e Komisionit, përkatësisht zëvendësit. Pyetësi i lëndës mund të jetë anëtar i Komisionit, i cili lëndën e ka specializim të ngushtë, ka gradë shkencore nga ajo lëndë, është magjistër i shkencës apo doktor i shkencave, ose ka përvojë pune pa ndërprerë 10 vjet si gjyqtar i lëndës”.

Duke marrë parasysh që zonja Nerxhivane Dauti ka qenë e propozuar në fillim të propozimit nga Ministria e Drejtësisë si zëvendëse, por jo në të drejtën civile, por në lëndët tregtare, Komisioni nuk është pajtuar me propozimin e parë dhe ka kërkuar sqarime nga Ministria e Drejtësisë, pse zonja Nerxhivane nuk është caktuar pyetëse për lëndën përkatëse? Unanimisht, për këtë të gjithë anëtarët e Komisionit jemi pajtuar.

Pas propozimit që e kemi dorëzuar në Ministri të Drejtësisë që të jepet sqarim për zonjën Nerxhivane, ka ardhur propozimi tjetër ku zonja Nerxhivane është eliminuar tërësisht si kandidate, gjëja me arsyetim se ka dhënë dorëheqje, komunikim që, për ne, nuk ka qenë zyrtar, e të cilin ju e keni në material. Është një fotografim që iu ka bërë një mesazhi të dërguar dikujt nga anëtarët e familjes.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka kërkuar me shkrim nga zonja Nerxhivane Dauti që të japë sqarim se a ka dhënë dorëheqje apo jo? Nerxhivane Dauti është deklaruar se nuk ka dhënë dorëheqje.

Prandaj, në takimin e fundit, duke pasur parasysh rëndësinë që ka pasur Komisioni dhe duke pasur parasysh që po presin shumë juristë të rinj që ta mbarojnë provimin e judikaturës, edhe pas kësaj periudhe dymujore, ne si Komision jemi detyruar që të bëjmë rekomandime duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit në pikën 46.2 ku thuhet se “Komisioni për Legjislacion apo komisionet, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, Rregulla 46 pikë 2, raporti duhet të përmbajë rekomandimet e Komisionit së bashku me arsyetimin përkatës dhe mendimin e kundërt”.

Prandaj, duke u bazuar në këtë rregull të Rregullores së Punës, ne i kemi rekomanduar Kuvendit të Kosovës që sot ta miratojë raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Faleminderit!

KRYETARI: Megjithatë, kërkesa është për t’u hequr kjo pikë e shtatë nga rendi i ditës. Kërkoj prononcimin e Grupit Parlamentar të AKR-së për këtë çështje. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne u pajtuam për këtë rend dite dhe nuk shoh arsye tash, meqë ne pasi të vendosim për një rend dite të tërheqim pikën nga rendi i ditës dhe sugjeroj që të procedohet me rendin e propozuar të ditës.

KRYETARI: Ju lutem, ne e shtuam rendin e ditës për një pikë, por nuk votuam për rendin e ditës. Do të thotë, tash është mocioni i zonjës ministre për ta tërhequr. Pra, cili është qëndrimi i grupit tuaj?

IBRAHIM MAKOLLI: Qëndrimi i Grupit Parlamentar të AKR-së është që të mos tërhiqet nga rendi i ditës kjo pikë.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Meqenëse në bazë të Ligjit Qeveria e propozon listën, do të thotë ministrja, ne mendojmë se, nëse kërkohet të tërhiqet, le të tërhiqet, sepse edhe ashtu po shohim se mund të ketë vota të ndryshme në Kuvend. Pra, e mbështesim kërkesën për tërheqje të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së e ka fjalën Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të flas edhe në emër të Grupit, por edhe si zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Komisioni, siç tha edhe kryetari, e ka shqyrtuar dy herë këtë çështje dhe herën e parë ka marrë vendim që t’ia kthejë prapa Ministrisë së Drejtësisë propozimet për dy arsye. E para, sepse kishte paqartësi rreth Ruzhdi Berishës, se a i plotëson a jo kushtet dhe, e dyta,

që ka qenë kryesorja e që s'e tha për fat të keq kryetari i Komisionit, ka qenë kërkesa e Komisionit që ky komision të jetë më gjithëpërfshirës, të mos jetë i dominuar në atë formë siç ka qenë i dominuar nga PDK-ja, ku ka qenë zëvendëskryeministri dhe një ministër, që mendojmë se është krejt jo etike, të mos them diçka tjetër, dhe kjo ka qenë arsyeja kryesore që ia kemi kthyer Ministrisë.

Në fjalën që e tha ministrja nuk del se janë shqyrtuar këto çështje dhe unë kam paqartësi të plotë se çka ka vendosur dhe çka ka kthyer Ministria.

Unë dhe Grupi ynë parlamentar mendojmë se ky propozim duhet t'i kthehet Ministrisë, të rishqyrtohet, të rishqyrtohen të gjitha aspektet, sepse ka paqartësi edhe rreth Nerxhivane Dautit, do të thotë a është propozim i Ministrisë apo s' është, një herë ka ardhur si zëvendëse e anëtarit, pastaj është eliminuar plotësisht, tash ka hyrë si anëtare e Komisionit e tjera. Domethënë, ka shumë paqartësi dhe mendoj se nuk është në rregull as në aspektin moral, as etik e as politik që të shkojmë në këtë formë me këto propozime kur ka edhe kundërshtime nga vetë ministrja e Drejtësisë. Prandaj, ne mendojmë se duhet të tërhiqet, të kthehet prapa dhe duhet të vijë një propozim më gjithëpërfshirës dhe më i argumentuar për anëtarët e këtij komisioni. Nëse shkon kështu, atëherë ky komision njëpartiak do t'i kalojë kandidatët e partisë së vet dhe do të kemi njerëz të jurisprudencës të dominuar plotësisht nga një parti e që do të dominojnë më vonë edhe në gjyqësi dhe gjyqësia jonë nuk do të jetë e pavarur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "7+" Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Ja nisam čuo šta najveća parlamentarna grupa misli po ovome da li da se povuče ili ne. Mislim, nije mi baš jasno da li da se prihvati predlog ministarke. A ako ona misli tako, mi ćemo ga prihvatiti. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsedniče!

Uvažene kolege poslanici i uvažene gospodo minsitri,

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u svakom slučaju podržava predlog ministarke da se sa dnevnog reda povuče 7. tačka. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, mendoj se është mirë të prononcoheni a jeni për ta hequr nga rendi i ditës. Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Nëse mbështetemi në Rregulloren e Punës, ne e dimë fort mirë se ai që propozon ka të drejtën e tërheqjes, prandaj ne, meqë ishim për t'u votuar sot, jemi që të tërhiqet ...

KRYETARI: Edhe një herë, ia jap fjalën ministres Nekibe Kelmendi.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Meqenëse, pothuaj të gjithë u deklaruan se pajtohen me tërheqjen nga rendi i ditës, edhe unë, si deputete, pajtohem për tërheqjen nga rendi i ditës, mirëpo kam edhe një sqarim.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk ka të drejtë që ta formulojë apo hartojë listën për provim të judikaturës, por ka të drejtë vetëm ta vlerësojë nëse është në përputhje me ligjin. Nëse nuk është në përputhje me ligjin, t’ia kthejë përsëri Ministrisë apo Qeverisë një vendim, e jo vetë ta ndryshojë vendimin.

KRYETARI: Faleminderit! Le të më lejohet edhe mua t’i sugjeroj Qeverisë, në këtë rast, që kur të hartojë listën për ta sjellë në Parlament, ta ketë parasysh ndarjen e pushteteve, sepse shpeshherë kjo nuk po merret parasysh. Pra, nuk mundet dikush të jetë edhe në ekzekutiv, edhe në legjislativ, edhe në gjyqësor. Mendoj se Qeveria, kur të përgatisë listën, duhet ta mendojë ndarjen e pushteteve, sepse ne nuk po e bëjmë në shekullin 21 ndarjen e pushteteve, është bërë shumë më herët.

Prandaj, kalojmë në votim formal.

Kush është për ta tërhequr nga rendi i ditës shqyrtimin e pikës 7?

Sekretaria, le t’i numërojë votat. Faleminderit!

A ka “kundër”? 8 janë “kundër”.

Abstenim? 2 abstenime.

Konstatohet se me shumicë votash, tërhiqet pika 7 e rendit të ditës.

Tani, fjalën e ka Driton Tali lidhur me rendin e ditës. Urdhëroni, deputet!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Duke pasur parasysh se tentova disa herë ta fus në rend të ditës diskutimin për letrën e Ban Ki Munit, unë edhe sot do të insistoj që Parlamenti, si organi më i lartë përfaqësues, të dalë me një qëndrim politik zyrtar lidhur me atë letër, e cila erozon Kushtetutën e Kosovës, Kushtetutë të cilën ky Parlament e ka miratuar, u mor vesh, në koordinim me kërkesat e partnerëve ndërkombëtarë dhe, si e tillë, është e obliguar që ta respektojë dhe jetësojë, ashtu sikur që janë të obliguar edhe institucionet e tjera shtetërore ta respektojnë çdo detaj të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të punojnë konform saj.

Të nderuar të pranishëm, letra e Ban Ki Munit, ashtu siç u deklarua edhe vetë autori se e kishte hartuar duke marrë parasysh edhe zgjedhjet jo legjitime të 11 majit dhe vandalizmit në pika doganore, jo vetëm në mënyrë indirekte, por edhe direkte i ratifikon strukturat paralele, sepse edhe ato fusha, si gjyqësia apo policia, për të cilat, sipas asaj letrë, duhet dialog në mes Kosovës dhe Serbisë – decentralizimi veç i rregullon në mënyrë unike, Siç dihet, ne decentralizimin nuk e kemi bërë në aspektin administrativ si e tërë bota e civilizuar, por në aspektin politik, pikërisht duke i marrë parasysh specifikat e veçanta. Andaj, për çka të dialogohet edhe më tutje. Nëse është qëllimi për krijimin e një realiteti të ri, domethënë, ndarjen funksionale të Kosovës mbi bazë të së cilës pastaj do të krijoheshin politikat separatiste, domethënë ndarja finale e Kosovës, ajo është çështje tjetër. Për më tepër, letra e Ban Ki Munit e shfuqizon EULEX-in dhe Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar, i cili, sipas planit të Ahtisarit, ishte autoriteti më i lartë civil politik në Kosovë. Domethënë, edhe ekzistenca e EULEX-it dhe e Zyrës Civile Ndërkombëtare e kanë humbur kuptimin.

Po ashtu, edhe ideja që EULEX-i të jetë pjesë e UNMIK-ut, i cili do të jetë neutral ndaj statusit të Kosovës, vetvetiu ia humb kuptimin EULEX-it. ngase për të ekzistuar

EULEX-i dhe Zyra Ndërkombëtare Civile është kushti që Kosova të ketë pavarësi të mbikëqyrur konform planit të Ahtisarit.

Pra, sipas asaj letre, PSSP do të jetë edhe më tutje autoriteti më i lartë politik dhe nuk ka nevojë për përfaqësuesit civil ndërkombëtarë. Me fjalë tjera, ne nuk mund t'i kemi dy institucione më të larta politike, sepse ato e përjashtojnë njëra-tjetrën. Logjikisht, ne mund të kemi ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! E harxhuat kohën që e kishit në dispozicion. Megjithatë, Parlamenti e ka miratuar Kushtetutën. Kushtetuta ka hyrë në fuqi dhe ne kërkojmë nga të gjitha organet që janë përgjegjëse zbatimin e Kushtetutës në tërë hapësirën e Republikës së Kosovës. Faleminderit, zoti deputet.

Në rregull, mund t'ia jepni edhe një minutë për ta vazhduar fjalën deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Jo, vetëm desha ta përfundoj dhe më duhet edhe pak kohë. Unë thashë se Kosova nuk mund t'i ketë dy institucione më të larta politike, sepse e përjashtojnë njëra-tjetrën. Logjikisht ne mund ta kemi vetëm një institucion të lartë politik, andaj le të merren vesh të tjerët se cilin do ta kemi: PSSP-në apo PCN-në? Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë po them, kjo çështje është e precizuar në Kushtetutë dhe ne si Parlament kërkojmë zbatimin e Kushtetutës në tërë hapësirën e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Me shefat e grupeve parlamentare, dje jemi marrë vesh që nga rendi i ditës të hiqet Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private. Lus të prononcohen shefat e grupeve parlamentare. Radhën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Ramë Buja.

RAMË BUJA: Meqë dje jemi dakorduar të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe me ju, zoti Kryetar, atëherë, Grupi Parlamentar mbështet këtë propozim.

KRYETARI: Në emër të LDK-së, shefi i Grupit Parlamentar, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, mbështes propozimin tuaj, respektivisht të Qeverisë që të tërhiqet nga procedura ligji i kërkuar nga ju. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. E ka fjalën deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së pajtohet që të tërhiqet kjo pikë nga rendi i ditës.

KRYETARI: Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së pajtohet që të tërhiqet nga rendi i ditës kjo pikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së pajtohet që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Zylfil Merxha, në emër të Grupit Parlamentar “7+”.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Edhe ne pajtohemi që të tërhiqet.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke podržava povlačenje sa dnevnog reda.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, me një votim formal duhet të deklarohejmë.
Kush është “për” ? Faleminderit!
A ka” kundër” ? Faleminderit!
Abstenim? Nuk ka.
Konstatoj se me shumicë absolute të votave, tërhiqet shqyrtimi i kësaj pike. Ju faleminderit!

Kemi kërkesën e Qeverisë së Kosovës si propozim që seanca e sotme të shtyhet deri në orën 14,00 Prandaj, punën e seancës do ta vazhdojmë në orën 14,00. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës në orën 14,00

KRYETARI: I nderuar Kabinet qeveritar,

Vazhdojmë seancën. Pika e parë e rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008

Ju njoftoj se procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008, si dhe transkripti nga kjo seancë u janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbal? Nuk kanë.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 30 qershor 2008.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit koha për pyetje e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Koha për parashtrimin e pyetjes është e kufizuar në një minutë, për përgjigje në pyetje tre minuta. Për pyetje

shtesë një minutë, për përgjigje në pyetjen shtesë dy minuta. Kërkoj respektim të këtyre rregullave.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve. Deputetja Suzan Novobrdaliu, AKR, pyetje për Kryeministrin e Kosovës zotin Hashim Thaçi.

Fjala e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje për të gjithë,

Pas luftës në Kosovë, fatkeqësisht, është rritur numri i vetëvrasjeve, duke i përfshirë këtu edhe të rinjtë. A ka ndonjë plan Qeveria se si ta parandalojë këtë dukuri që po i shkakton shumë dhimbje Kosovës, si dhe a i ka hulumtuar shkaqet e vetëvrasjes, a janë vështirësitë ekonomike, traumat e pasluftës apo arsyet e tjera personale?

KRYETARI: Faleminderit! Nekibe Kelmendi e ka fjalën që të përgjigjet në këtë pyetje.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Qëndron fakti se pas luftës është rritur numri i vetëvrasjeve. Nuk është bërë një studim i hollësishëm për shkaqet e vetëvrasjes, por statistikatat flasin se numri është rritur.

Sipas mendimit tim, nuk është punuar mjaft pas luftës me profesionistët për trajtimin e këtyre personave të cilët, sidomos të rinjtë, kanë pësuar trauma gjatë luftës dhe, sikur të ishte punuar me ta, me siguri se pasojat nuk do të ishin kaq fatale. Numri do të ishte shumë më i vogël.

KRYETARI: Pyetje shtesë? Deputetja Suzan Novobrdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!
Mua më befasoi përgjigjja, sepse kam pritur krejt përgjigje tjetër, duke marrë parasysh këtë rëndësi të madhe që e ka kjo dukuri aq e keqe për Kosovën. Nuk kam pyetje shtesë. Me të vërtetë jam e befasuar.

KRYETARI: Faleminderit! Ministre, 2 minuta i ke.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Na vjen shumë keq për këtë numër që është rritur dhe është shumë brengosës për ne, sidomos për faktin se më së shumti po marrin pjesë në vetëvrasje të rinjtë, që do të thotë se ata gjatë atyre 10 vjetëve të okupimit dhe gjatë luftës kanë qenë fare të rinj dhe tash kanë arritur një moshë kur është dashur më tepër të punohet me ta nga ana e ekspertëve për trajtimin e traumave. Mirëpo, dua të them një të vërtetë se Kosova para se të okupohej ka pasur numrin më të vogël të vetëvrasjeve në ish-Jugosllavi me 0,03%.

KRYETARI: Faleminderit!
Pyetja e dytë. Suzan Novobrdaliu, nga AKR, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e keni fjalën.

SUZAN NOBRDALIU: Faleminderit, Zoti Kryetar!

Jemi dëshmitarë të përqindjes së madhe të të papunëve në Kosovë, duke i përfshirë edhe qytetarët e moshës mbi 45 deri në 65 vjet. Në këtë kategori janë, zakonisht, personat që më herët kanë punuar dhe kanë mbetur pa punë për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve të tyre ose kanë qenë të përjashtuar nga puna gjatë viteve të 90-ta e të cilët më vonë pas 10 vjetëve për shkak të moshës nuk kanë mundur të punësohen më. Tani, ata janë pa të ardhura, pa ndihma, në një ose mënyrë tjetër nuk mund të rikualifikohen, kështu që mundësia e punësimit të tyre është shumë e vogël. Pyetja: A ka ndonjë plan të veçantë Qeveria e Kosovës për këtë kategori të qytetarëve?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kryeministër. Ahmet Shala përgjigjet në këtë pyetje.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit për këtë pyetje, zonja deputete!

I nderuari Kryetar,

I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kolegë ministra,

Deputetë të nderuar,

Çështja e papunësisë është sfidë dhe do të jetë sfidë edhe për shumë vjet. Privatizimi, në fakt, në njërin anë ka shkaktuar papunësi për ata të cilët ashtu edhe kështu do të mbeteshin pa punë, qoftë për shkak të moshës, qoftë për shkak të mosaftësive të tyre të konkurrimit në tregun e punës, ndërsa në të njëjtën kohë janë krijuar vende të reja të punës. Sipas disa statistikave, që unë pasi i mbaj në mend freskët, diku mbi 8000 vende të punës janë krijuar vetëm përmes spinofit special. Ndërsa, përmes spinofit të rregullt janë krijuar diku rreth 12 mijë vende të punës.

Natyrisht, për çdo vjet në Kosovë kontingjentit të punës i shtohen diku 22 mijë deri 25 mijë veta. Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë po përpiqet që çështjen e punës, përkatësisht të papunësisë ta zgjedh duke përgatitur kuadro të specializuar konform planit dhe programit të Ministrisë së Arsimit për përmirësimin e arsimit, kuadro të cilat do të jenë të gatshme të konkurrojnë në tregun e punës më mirë se sa deri më sot, një.

Dy, zhvillimi i sektorit privat dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese në Kosovë, fillimi i këtij viti dhe vitet që po vinë kanë treguar një trend të lëkundjes pozitive, por kjo do të jetë një sfidë në të ardhmen. Ne po përpiqemi që gjatë reformës së politikave fiskale, të cilat Qeveria në parim i ka adaptuar, të bëjmë zvogëlimin e taksave në pagat individuale dhe të njëjtën mënyrë, pra, të zvogëlohet barra fiskale për punëdhënësit dhe punëmarrësit, në mënyrë që të shtohet mundësia e një tregu më të gjerë të punës dhe në bashkëpunim me disa nga ministritë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka avancuar, në bashkëbisedim me disa partnerë evropian, me Francën, me Zvicrën, kemi bashkëbisedime, me Finlandën sa di unë, Ministria e Arsimit dhe disa nga ministritë e dikastereve përkatëse për të bashkë identifikuar projektet të cilat mund të përgatisin kuadrot në Kosovë për trajnim për punë në vend, këtu apo në vendin përkatës ku inicohet punësimi.

Disa nga marrëveshjet e ish- Jugosllavisë që i ka pasur me shtetet e ndryshme, siç janë me Gjermaninë dhe me disa shtete evropiane, mbase mund të negociohet. Unë

personalisht kam biseduar me Qeverinë Gjermane që të shfrytëzojmë kontingjentin e punës që i takon ose i ka takuar.....

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

A keni pyetje shtesë deputete? Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ka, zoti Kryetar.

Përgjigja ishte shumë e përgjithësuar, papunësinë e përmendët si çështje. Domethënë, këtu ishte pyetja ime për kategorinë e caktuar të personave të moshës 45- 55 vjeçare të cilët nuk po i rikualifikoni, mirëpo edhe nuk po i punësoni. Unë për këtë e pata pyetjen.

KRYETARI: Zoti ministër, mund ta vazhdoni përgjigjen. Dy minuta.

MINISTRI AHMET SHALA: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbase sigurisht që do të ketë përgjigje më të saktë në te, megjithatë kuadrat e asaj moshe vërtet e kanë vështirë për të gjetur punë në **konkurrencën me** të cilën ballafaqohemi tani, sidomos në Kosovë kur kontingjenti i të rinjve është, nëse mund të them, për të konkurruar karshi moshës më të vjetër.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka programin e trajnimeve në bashkëpunim me donatorët e ndryshëm dhe një nga projektet që janë në kuadër të donacioneve është edhe përgatitja e kudrave që kanë një përvojë, por mbase për shkak të transformimit ose riformimit të ekonomisë në përgjithësi, kanë nevojë për trajnime me qëllim të adaptimit.

Gjithashtu, gjatë riorganizimit të ndërmarrjeve të mëdha publike duhet të jemi të kujdesshëm që kuadrat e moshës së shtyrë të futen në programe trajnuese dhe një nga elementet e asistencës teknike të fokusohen gjatë hartimit të kriterëve për shfrytëzimin e projekteve të donacioneve në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, AAK, pyetje për Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e keni fjalën për të bërë pyetje.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Para se ta shtroj pyetjen, dëshiroj t'i tërheq vërejtjen Kuvendit dhe juve si Kryetar, që të mos lejoni imponimin e agjendës së Qeverisë. Sot çfarë keni bërë, është shtyrja e seancës nga ora 10,00 në orën 14,00, duke ia lënë Qeverisë që të na imponojë agjendën. Dihet kush e bën agjendën.

Pyetja ime për ju, zotëri Kryeministër, është se tanimë 43 shtete e kanë njohur Kosovës. Ju keni deklaruar qysh në shkurt 2008 se së shpejti 100 shtete do ta njohin Kosovën. Cilat veprime i ka marrë Qeveria për të siguruar edhe 60 shtete të tjera të cilat ju keni deklaruar se do ta njohin Kosovën?

KRYETARI: Zoti Kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, deputete për pyetjen që është me interes për gjithë në Kosovë, natyrisht edhe për miqtë tanë. Prandaj, dua të theksoj se institucionet e shtetit të Kosovës, Qeveria që unë drejtoj, duke ndjekur linjën e

ngushtë të bashkëpunimit dhe të bashkëveprimit të thellë me partnerët tanë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, janë duke punuar fuqishëm në procesin e njohjes së shtetit të pavarur sovran dhe demokratik të Kosovës.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë një veprim i koordinuar, por edhe njohja është veprim i koordinuar. Procesi është duke shkuar mirë dhe po të krahasojmë njohjen e shtetit të Kosovës me njohjet e shteteve të tjera, në veçanti të ish- Jugosllavisë, për Kosovën ka ndodhur mrekullia. Ka ndodhur, pikërisht, për shkak të punës, përgjegjësisë së përbashkët, një përgjegjësi e nivelit tepër të lartë dhe sot kemi njohjen e 2/3 të vendeve të Bashkimit Evropian për Kosovën, e 2/3 të vendeve të NATO-së, të 7 vendeve të G8-të, të SHBA-ve, do të thotë të Japonisë.

Por, edhe në ndërkohë duhet kuptuar se diplomacia është një proces kompleks, jo punë mekanike apo afate kalendarike. Ne jemi shtet i vogël, por e nderuara deputete, kemi miq të mëdhenj, shumë të fuqishëm.

Ne së shpejti me Presidentin Sejdiu do të kemi një takim jashtëzakonisht të rëndësishëm në Shtëpinë e Bardhë me Presidentin Bush dhe kjo ftesë është ftesë e suksesit për Kosovën. Prandaj, në rrafshin ndërkombëtar rrjedhimet diplomatike të këtij takimi do të jenë jashtëzakonisht të mëdha dhe shumë pozitive për Kosovën. Prandaj, perspektiva është e sigurt në bashkësinë e popujve të lirë. Ndërkohë, pas suksesit në Konferencën e Donatorëve, e në veçanti tash, pas aplikimit për anëtarësim në Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, por edhe të kërkesës për aplikim në IBRD, unë dua të besoj fuqishëm se jo nga 100 shtete, por nga të gjitha vendet e botës shteti i Kosovës do të njihet shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

Natyrish që koha është shumë e rëndësishme, zoti Kryeministër, sepse në vjeshtë mbahet Asambleja e Përgjithshme dhe Kosova do të mund të aplikonte. Unë ju pyeta shumë konkret, fjalën që ju vet e keni thënë. Kur ju mund të na siguroni, na thoni të vërtetën, se do ta siguroni njohjen e 60 shteteve të tjera që të mund të aplikojmë për anëtarësimin në OKB?

KRYETARI: Keni përgjigje, zoti Kryeministër?. Urdhëroni, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë e rikonfirmoj përsëri sot se jo nga 100 shtete, por nga 193 shtete, shteti i Kosovës do të njihet.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Urdhëro, lexojeni pyetjen, deputete.

GJYLNAZE SYLA: Mos u nervozoni, zoti Kryeministër!

Republika e Kosovës ka marrë obligimet për përmbushjen e dispozitave që dalin nga Plan i Ahtisarit. Sipas planit të Ahtisarit, pas periudhës 120 ditëshe mandati i UNMIK-ut pushon, pushteti i UNMIK-ut bartet tek institucionet, kurse misioni i BE-së merr

përgjegjësinë për ushtrimin e mandatit të vet. Duke marrë parasysh se më 15 qershor ka hyrë në fuqi Kushtetuta dhe ka filluar zbatimi i përgjegjësive për institucionet e Kosovës, ju pyes juve, zoti Kryeministër, cili është qëndrimi i Qeverisë për rolin e UNMIK-ut dhe çfarë ka bërë Qeveria që të sigurojë zbatimin e dispozitave të përcaktuara për UNMIK-un? Pres një përgjigje konkrete.

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Edhe njohja nuk është vetëm vendim i Qeverisë së Kosovës apo i Parlamentit të Kosovës, por është vendim i qeverive dhe të kuvendeve të vendeve të tjera. Por, të jetojmë me optimizmin dhe shpresën e fuqishme se vendi ynë do të ketë sukses të plotë dhe jam i bindur bashkë me ju në këtë drejtim. Unë nuk jam aspak nervoz, përkundrazi jam shumë i zotuar dhe shumë i fuqishëm që të punoj me përkushtimin më të lartë në sukseset që po arrijmë. Prandaj, ju ftoj edhe juve që t'i gëzoheni suksesit të vendit tonë.

Ndërkohë, dua të potencoj , të ndërlidhem te pyetja e juaj. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë krijuar rrethana të reja. Me ftesën e gjithë neve këtu, kemi të bëjmë me një rikonfigurim të ri të prezencës civile ndërkombëtare. Ky rikonfigurim ka qenë i mirëpritur, i mirëseardhur dhe i ftuar nga të gjithë ne, prandaj sot jetojmë në një realitet të ri politik dhe kushtetues.

Bashkësia ndërkombëtare ka njohur këtë realitet edhe UNMIK-u ka bërë të qartë se do të sillet konform këtij realiteti, do të thotë, në rolin e ri të Organizatës të Kombeve të Bashkuara. Unë dua edhe sot ta falënderoj Organizatën e Kombeve të Bashkuara për rolin e saj të rëndësishëm dhe tranzicionin demokratik që ka bërë në Kosovë.

Dikur, dua ta potencoj se realiteti kosovar i përshtatej UNMIK-ut, ndërsa tash po ndodh e kundërta. OKB ka marrë një rol tjetër, t'i përshtatet realitetit kosovar. Institucionet e Republikës së Kosovës janë duke marrë të gjitha përgjegjësitë kushtetuese që u takojnë.

Në anën tjetër, prania civile e Bashkimit Evropian në Kosovë është një element shumë i rëndësishëm për të ardhmen tonë, që është integrimi në strukturat euroatlantike dhe përkrahja edhe në Konferencën e Donatorëve, që ishte një përkrahje e fuqishme për Kosovën prej 36 shteteve përfaqësuesve të tyre dhe 16 organizatave të tjera ndërkombëtare, ka qenë një përkrahje e jashtëzakonshme për rolin dhe suksesin e institucioneve të Kosovës dhe ky sukses, natyrisht, i takon Qeverisë dhe të gjitha institucioneve të vendit. Kur flas për institucionet, flas edhe për Kuvendin..

Prandaj, prania e BE-së është një përparësi e madhe për Kosovën, sepse ne ende jemi në një tranzicion. Këtë prani ndërkombëtare unë do ta quaj mbështetje ndërkombëtare shtesë për Kosovën në rrugën tonë të

(Ndërprerje e incizimit nga regjia)

KRYETARI: Deputete, a keni pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

Zoti Kryeministër, është e qartë që nuk e keni lexuar pyetjen dhe as nuk e keni përgatitur, por siç pati thënë Kryetari në mbledhjen e kaluar: "Qeveria ka halle". Pyetja ime shtesë është: A i keni propozuar, si Qeveri, plan operacional i cili duhet të dilte nga Plan i Ahtisarit bashkësisë ndërkombëtare, gjegjësisht aktorëve kryesor ndërkombëtarë ?

KRYETARI: Përgjigje, zoti Kryeministër?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete, Qeveria ka plan, ka program, Kosova ka Kushtetutën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë i kam disa pyetje, tash më thatë për zotin Kryeministër, do ta bëj. Kohë më parë, në media u publikua një letër në të cilën ish -drejtori i AKM-së, zoti Xhon Xhonson, në mënyrë eksplicite implikon ministrin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zoti Ahmet Shalën, atëherë, zëvendësdyrëtor i AKM-së se ka qenë i involvuar në mënyrë direkte në privatizimin e Feronikelit. Kjo rrit edhe më shumë aligacionet se gjatë privatizimit të Feronikelit ka pasur marrëveshje të brendshme. Pyetja është: Çfarë do të merrni ju konkretisht në këtë rast, duke pas parasysh premtimet e dhëna gjatë fushatës, por edhe tashti sa jeni në qeverisje, se do të udhëhiqni me duar të pastra dhe do të keni zero tolerancë ndaj korrupsionit? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën,

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti deputet,

Dua të ritheksoj edhe një herë, mbështetja e jashtëzakonshme që ka marrë Qeveria e Kosovës në Konferencën e Donatorëve prej të gjitha shteteve pjesëmarrëse, ka qenë mbështetje për Kosovën, ka qenë vlerësim për qeverisjen e mirë, vlerësim për instalimin e sundimit të ligjit, të vlerësimit zero tolerancë në kuptimin e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, të përkushtimit tonë të thellë për implementimin e gjitha kritereve demokratike dhe të orientimit të qartë për integrim euroatlantik.

Nuk dëshiroj të merrem me spekulime mediale as të komentoj letra private. Të gjitha faktet tregojnë se politika jonë e tolerancës zero ndaj korrupsionit është duke u zbatuar në përpikëri dhe ligji do të funksionojë njëjtë dhe para ligjit do të jetë i barabartë kushdo që të jetë ai, kudo që paraqitet ndonjë dukuri negative. E kam theksuar edhe më herët, e theksoj edhe sot dhe jam i zotuar edhe në të ardhmen, por edhe për jetë, zero tolerancë ndaj krimit dhe korrupsionit përderisa unë udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Dua të potencoj se edhe bota demokratike ka mbështetur Kosovën, e ka mbështetur mbi këto parime që qeveriset sot Kosova, e ka mbështetur mbi ato parime, mbi atë përkushtim dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme që është duke u treguar në këtë fazë të qeverisjes së Kosovës. Prandaj, sot Kosova ka qeverisje stabile, funksionim demokratik efikas të institucioneve, por edhe një mbështetje të jashtëzakonshme ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputet, a keni pyetje shitesë? E keni fjalën.

DRITON TALI: Po zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, me gjithë respektin, unë duke pasur parasysh strategjinë tuaj, edhe një letër shumë serioze nga një person shumë serioz, e kam hapur këtë pyetje t'ia rikujtoj se Feronikeli kur është privatizuar në atë kohë, flas me të dhënat e 1 qershorit 2005, që ka pasur vlerë mbi 3 miliard dollarë, duke pasur parasysh vetëm nikelin në minierën e Dushkajës, të Sukës dhe të Gllavicës, pra pa i marrë parasysh 25 hektarët në Magurë dhe Medevc. Pra, kemi të bëjmë me një korporatë shumë serioze, me gjigantin më të madh që e kemi dhe çdo dyshim, çdo aligacion duhet të merret seriozisht. Singërisht po ju them, unë pres nga ju që këtë aligacion ta shqyrtoni deri në detaje dhe të kërkonit përgjegjësi nga kushdo qoftë ai. Faleminderit!

KRYETARI: Përgjigje, zoti Kryeministër? Dy minuta.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti deputet, pajtohem plotësisht me përkushtimet tuaja, përkushtimet tuaja janë pjesë e përgjegjësisë tona të përbashkëta, por dua të potencoj se letrat private nuk mund të shpallin aktgjykimin, nën një, sot është person privat ai.

Nën dy, vetëm një fakt i argumentuar nga gjykatat, të jesh i bindur se asnjë ministër, asnjë minutë nuk do të jetë ministër.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputetja Donika Kada - Bujupi, pyetje për Kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën.

DONIKA KADAJ : Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,
I nderuar Kryeministër,

Keni deklaruar që do të angazhoheni personalisht që bashkatdhetarët tanë të kenë lehtësira dhe mundësi më të mira të pajisen me dokumente dhe kërkesa të tjera gjatë qëndrimit në Kosovë. Ndërkaq, sezoni i pushimeve ka filluar dhe sportelet janë të stërmbushura me radhë të gjata të bashkatdhetarëve që presin të pajisen me dokumente të Republikës së Kosovës dhe nuk gëzojnë asnjë nga lehtësirat e premtuara. Kur do të merreni seriozisht me zotimet e bëra dhe pse anashkaloni edhe këtë pjesë të shoqërisë, e cila po ballafaqohet me problemet e shumta, e cila realisht është një pjesë e shoqërisë shumë meritore, e cila brenda vitit në Kosovë, ndër të tjera, edhe fut të hyra prej miliona eurosh?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,

Fillimisht dua të falënderoj gjithë diasporën për kontributin e tyre që e kanë dhënë. Në të njëjtën kohë dëshiroj t'ju uroj mirëseardhje në vendlindje, në Kosovën e pavarur, për herë të parë këtë vit, në kuptimin e Kosovës si shtet i pavarur sovran dhe demokratik.

Tjetër, është një pyetje interesante sa për t'u bërë, sepse Qeveria e Kosovës veç ka marrë masat, ka marrë vendim që të hapen sportele të veçanta në çdo komunë, në çdo vend të nevojshëm.

Tjetër, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punëve të Brendshme është afër finalizimit të procesit edhe për prodhimin e dokumenteve civile të Republikës së Kosovës. Të gjitha përgatitjet janë në përfundim e sipër dhe janë në nivelin e duhur dhe të lartë profesional. Tanimë është marrë vendimi që të gjitha departamentet në nivel të ministrisë përkatëse, por edhe të ministrive të tjera të punojnë edhe me orar të shtuar, duke përfshirë edhe ditët e vikendit, në mënyrë që të përballen me nevojat e qytetarëve tanë edhe brenda, por edhe jashtë vendit. Prandaj, kjo është qasja dhe rezultati i Qeverisë së Kosovës. Ne nuk mund t'u ofrojmë bashkatdhetarëve ahengje, por do të jemi plotësisht në shërbim të tyre.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

DONIKA KADAJ: Faleminderit, Kryetar!

Sa për ahengje, Kryeministër, po organizoni. Kohëve të fundit keni qenë edhe në Burim dhe po na intereson, prej cilave mjete, se po i keni 10, 20 këngëtarë aty dhe mijëra qytetarë, hyrja falas, do ta gjejmë edhe rreth ahengjeve, si po paguhen ahengjet.

Sa i përket përgjigjes suaj, nëse pyetja ime ishte sa për t'u bërë, përgjigja juaj ishte sa për marketing. Unë ju inkurajoj që të dilni në komunat e Kosovës, duke filluar prej Prishtinës dhe të shihni që në sportele janë me mijëra qytetarë të diasporës që presin në mungesë të shërbimeve adekuate. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, përgjigje shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Me gjasë qenke keq e informuar. Është e vërtetë se ne kemi mbajtur mbledhje si Qeveri në Burim dhe kemi qenë tërë ekipi qeveritar, por edhe shumë ndërkombëtarë e në të njëjtën kohë edhe autoritet komunale dhe jam tepër i kënaqur me interesimin, fokusimin për investim edhe në atë komunë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Një vërejtje për deputetët. Nën një, pyetjet i keni bërë për përgjigje me gojë dhe përgjigjet po i merrni me gojë. Dy, pyetjet i keni bërë për marketing dhe marketing po merrni.

Deputetja Synavere Rysha, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, parashtroje pyetjen!

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, Kryetar!
Përshëndetje për të gjithë,

Të paktën pyetja ime nuk është për marketing. Unë i drejtohem Kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, për faktin se shumë punëtorë kanë mbetur pa paga gjatë procesit të zgjedhjeve, por nga ata punëtorë dihet se më së shumti kanë qenë të përfshirë pjesa nga arsimi. Edhe pse ju premtuan shumë arsimtarëve nuk ndodhi asgjë. Të paktën ata presin për realizimin e atyre pagave, që kjo ndodhi, ndoshta, edhe më tepër si proces, si

mosmarrëveshje në mes Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe asaj të Shërbimeve Publike, sepse njëra dërgon një shkresë që punëtorët duhet të shkojnë në pushime pa pagesë, tjetra thotë duhet të shkojnë në pushime me pagesë, prandaj kryetarët e disa komunave dhe kryeshefat ekzekutiv i lëshojnë disa aktvendime ku punëtorët i qojnë në pushim me pagesë. Realisht, ata kanë fituar të drejtën për realizimin e pagave të tyre. Prandaj, pyetja ime konkrete është për Kryeministrin.

KRYETARI: Përgjigjet zëvendëskryeministri zoti Hajredin Kuçi. Shfrytëzojeni kohën, e keni një minutë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonja deputete! Besoj që pyetjen e kemi marrë me kohë dhe po përpiqemi që edhe të përgjigjemi ashtu si e kemi marrë pyetjen.

Ju e dini se ekziston një urdhëresë administrative e vitit 2003/2 që zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, ku ndër të tjera thuhet: "Sekretarët e përhershëm, nëpunësit kryesor ekzekutivë dhe drejtorët e departamenteve duhet të japin dorëheqje nëse mendojnë të marrin pjesë si kandidat në zgjedhje." Ndërsa, në pikën 28.4 të këtij udhëzimi administrativ, thuhet: "Përveç sekretarëve të përhershëm, nëpunësve kryesor ekzekutivë dhe drejtorëve të departamenteve, nëpunësit civilë mund të paraqesin kandidaturën për ndonjë funksion të zgjedhur publik, por ata duhet të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil, i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre". Kjo është marrë nga Qeveria paraprake dhe mendoj që ka qenë në përgjithësi dhe në përputhje të plotë me udhëzimin administrativ.

Qeveria e Kosovës është e obliguar që ta respektojë legjislacionin ekzistues në fuqi dhe mbi bazën e tij edhe kemi vepruar. Nëse Kuvendi vendos që të ndryshohet legjislacioni, ne do ta respektojmë.

KRYETARI: Faleminderit!
Deputete ke pyetje shtesë.

SYNAVERE RYSHA: Pyetja ime është konkretisht për arsimtarët. Ata nuk janë staf i lartë, nuk janë drejtorë, nuk janë menaxherë, janë pjesë e shërbyesve civilë, por megjithatë nuk janë staf i lartë. Ministria e Pushtetit Lokal ka dërguar nëpër komuna një urdhëresë administrative, ku kërkon nga kryeshefat që shërbyesit civilë t'i dërgojë në pushim me pagesë. Prandaj, konform asaj, unë flas për komunën time, nga komuna që vij. Në komunën e Ferizajt kryeshefi ekzekutiv ka lëshuar aktvendime dhe punëtorët i ka dërguar në pushim me pagesë. Prandaj, krahas atyre aktvendimeve, ata kanë realizuar të drejtat e tyre. Si do të veprohet në këtë rast, zoti Kryeministër.

KRYETARI: Zoti Kuçi, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonja deputete! Ndoshta nuk isha shumë i qartë, por ju besoj e dini që edhe mësimdhënësit janë shërbyes civilë dhe kjo rregull vlen edhe për mësimdhënësit, ku thuhet se edhe ata duhet të paraqiten, të heqin dorë nga marrëdhënia e punës pa pagesë. Një javë pasi të shpallen rezultatet e zgjedhjeve, nëse nuk e fitojnë kandidaturën, kthehen në vendin e tyre të punës. Besoj se ashtu edhe kanë bërë. Pra, rregullativa ekzistuese është që

mësimdhënësit janë shërbyes civilë dhe kjo dispozitë vlen edhe për ata në mënyrë të njëjtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin. Deputet, e keni fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Qeveritarë dhe deputetë të respektuar,

Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës aktualisht nga serbët kosovarë të suportuar dhe të sponzoruar nga shteti serb, të instrumentalizuar dhe të dirigjuar nga atje, në mënyrë më flagrante nëpërmjet nëpërkëmbjes së rendit kushtetuar dhe juridik të Republikës së Kosovës, pa përfillje të realitetit aktual legal ndërkombëtarisht të njohur në Kosovë, organizimit dhe mbajtjes së zgjedhjeve ilegale në territorin e Republikës së Kosovës, konstitutimit të strukturave reprezentative ilegale në Kosovë, ushtrimit të dhunës kundër qytetarëve dhe autoriteteve kosovare, pa skrupull e injorojnë dhe e cenojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, në funksion të vënies....

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti Kryeministër, përgjigjen. Zoti deputet, e ke harxhuar kohën, shfrytëzoheni kohën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti Smaka,
Institucionet e Republikës së Kosovës e kanë në krye këtë agjendë dhe këtë çështje. Kosova është shtet i pavarur sovran demokratik me integritet territorial të njohur ndërkombëtarisht të paprekshëm. Prandaj, integriteti territorial i vendit është i njohur dhe ne po punojmë pandërprerë me gjithë partnerët ndërkombëtarë civilë dhe NATO-n që hap pas hapi të vendosim rendin kushtetues në çdo cep të vendit. Por, unë nuk mund të veproj me inercionin apo qasjen e gabuar e nxitëse të ndonjë grupacioni të manipuluar apo të dështuar në politikë e që pretendon të nxitë gjërat e tilla të panevojshme në këtë kohë të procesit të njohjes së shtetit të pavarur sovran dhe demokratik. Të ashtuquajturat struktura paralele janë iluzore, ato nuk do të funksionojnë në Kosovë.

Prandaj, dua të potencoj se ka ikur koha e shikimit nga e kaluara, por në të ardhmen dhe për të ardhmen do të ketë vetëm respektim të integritetit territorial të Kosovës dhe rend kushtetues në tërë territorin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetje shtesë, deputet?

RIZA SMAKA: Me gjithë konsideratat e larta për personalitetin e zotit Kryeministër, të zëvendëskryeministrave, të ministrave, të Qeverisë, megjithatë konkludoj me keqardhje se sovraniteti dhe integriteti i Kosovës në konform me nenin 1 paragrafi 1, neni 2 paragrafi 1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, cenohen në mënyrë flagrante dhe të patolerueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin. E keni fjalën përsëri.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Aktualisht në Republikën e Kosovës çmimet e artikujve jetësorë elementarë, veçanërisht për qytetarët ordiner të saj, janë në vllug të pandalur të inflacionit irracional në kundërshtim me rregullat fundamentale të ekonomisë së tregut *jus imperativum* dhe të interesave vitale të po atyre qytetarëve.

Zoti Kryeministër, çfarë ka planifikuar dhe programuar konkretisht mundësisht Qeveria e Republikës së Kosovës për këtë temë topike delikate me rëndësi për jetesën elementare të shumicës absolute të qytetarëve të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për këtë pyetje, përgjigjet ministri për Ekonomi dhe Financa, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti deputet,

Mbasi kjo pyetje është shtruar edhe elaboruar edhe një herë në këtë Parlament, por megjithatë më lejoni që në pika të shkurtra t'i përsëris shumicën nga ato që janë thënë.

Qeveria e Kosovës e ka marrë shumë seriozisht çështjen e problemeve që shkaktojnë trendet ndërkombëtare të ngritjes së çmimeve, e të cilat janë të pakontrollueshme nga forca ekonomike e Kosovës. Megjithatë, Kryeministri i Kosovës tanimë i ka bërë publike prioritetet e veta sa i përket shqyrtimit të pagave të arsimtarëve dhe ne që nga shtatori do të fillojmë t'i adresojmë këto përmes certifikimit të arsimtarëve, ku shumica e tyre do të kenë një pagë shtesë konform rezultateve të certifikimit.

Tjetër, në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë: Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, USAID-n deri në fund ose mesi i vjeshtës ose fundi i verës, do hartojmë Letrën e Bardhë, e cila do t'i përfshijë të gjitha problemet sociale, duke përfshirë edhe pensionistët edhe çështjet e invalidëve të luftës, përkatësisht njerëzit të cilët nuk kanë mundësi që të luftojnë me sfidat që i ballafaqojnë çmimet, përkatësisht edhe problemi i papunësisë. Të gjitha këto do të shtrohen në një letër, e cila besoj që do jetë e pranueshme edhe për ju dhe për partnerët tanë ndërkombëtarë dhe do adresohen të gjitha këto elemente, në mënyrë shumë..., me konsensus ndërkombëtar.

Elementi tjetër, gjatë reformës së politikave fiskale ne veç kemi ndërmarrë zvogëlimin e taksave në paga, e cila në një mënyrë apo tjetër, do të zvogëlojë mundësinë për evazion fiskal dhe në të njëjtën kohë do të rritë buxhetin e Kosovës dhe do të adresohen edhe disa nga elementet e tilla.

Në kuadër të Konferencës së Donatorëve kjo është një nga elementet që është shtruar dhe kemi mbështetjen ndërkombëtare për ta zgjedhur këtë. Pra, do jeni dëshmitarë se ne që nga shtatori do të fillojmë t'i zgjidhim një nga një këto. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, për kohën!

Pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Duke i mbështetur të gjitha përpjekjet dhe duke i vlerësuar lart angazhimet, kam dëshirë ta nënvizoj faktin se Qeveria e Republikës së Kosovës, pos letrave e apeleve, ka edhe instrumente juridike- legale në konformitet me karakterin,

natyrën e ekonomisë së tregut -jus dispozitivum për të ndërmarrë edhe masa legale kundër tërbimit të çmimeve që shkojnë në disfavor të jetesës elementare të shumicës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë, pyetje shtesë nuk ka. Vazhdojmë, deputetja Donika Kada- Bujupi, pyetje për ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Skënder Hyseni. Deputete, e keni fjalën.

DONIKA KADA- BUJUPI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar ministër.

Procesi i njohjes së pavarësisë së Kosovës ka ngecur dhe jemi në një periudhë alarmante kur ky proces po neglizhohet dhe po rrezikohet si i tillë. Kjo sidomos vjen në mungesë të lobimit dhe qasjes më profesionale nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ndërkohë, në diasporë kemi mijëra bashkatdhetarë të cilët kanë kapacitete dhe vullnet që të përkrahin këtë proces. Pse po neglizhohen këta njerëz dhe pse kur është fjala për projekte madhore-kombëtare Qeveria po heziton t'i përfshijë të gjithë qytetarët e Kosovës?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Zonja deputete Kada,

Siç e thoni edhe ju, procesi i njohjes së Kosovës është proces. Si i tillë, ai ka dinamikën e vet që vërtet është dinamikë që ua japin palët në këtë proces dhe palë në këtë proces është Kosova, në njërën anë, dhe vendet nga të cilat Kosova ka kërkuar njohje zyrtare ditën e shpalljes të pavarësisë.

Ditën e shpalljes të pavarësisë, Republika e Kosovës, me një letër të nënshkruar nga Presidenti i Kosovës dhe Kryeministri i Kosovës, ka kërkuar njohje zyrtare nga të gjitha kombet e lira të rruzullit tokësor.

Në këtë drejtim ne duhet të jemi të vetëdijshëm që vendimi për njohje mbetet në diskrecion të plotë të secilit vend veç e veç, të cili Qeveria e Kosovës, institucionet e Kosovës kanë bërë kërkesë për njohje. Është detyrë e institucioneve të Kosovës, e Presidentit, e Kuvendit dhe e Qeverisë së Kosovës që ta përfaqësojnë Kosovën institucionalisht.

Vënia e kontakteve me shtetet e tjera është vetëm një dimension i punës së Qeverisë në planin e politikës së jashtme. Ministria e Punëve të Jashtme, që nga nominimi i ministrit ka vënë kontakte të shumta të përditshme me përfaqësues diplomatikë, me ambasadorë, ministra e kryeministra të vendeve të ndryshme. Deri me tash, ministri i Punëve të Jashtme ka pasur rreth 50 takime, me qëllim të parë shtyrjen përpara të procesit të njohjes së Republikës së Kosovës.

Këto takime të rëndësishme të lartë, kanë përfshirë vende të kontinenteve të ndryshme me interesa politike e ekonomike të ndryshme, po ashtu, dhe kultura të ndryshme. Gjithsesi, Ministria e Punëve të Jashtme vijon punën në këtë plan me gjithë kapacitetet e saja

ekzistuese dhe po kështu bën edhe Presidenti i vendit dhe Kryeministri me të gjithë ministrat e tjerë.

Sa i takon angazhimit të diasporës sonë, për të cilën Ministria e Punëve të Jashtme ka respekt të veçantë, më duhet të theksoj që të gjitha vendet ku Kosova ka një diasporë të ndjeshme, e kanë njohur tashmë shtetin e pavarur dhe sovran të Kosovës, edhe falë angazhimit të pashoq dhe të pakursyer të shumë njerëzve, të përfaqësuesve eminentë të diasporës së Kosovës.

Sido që të jetë...

KRYETARI: Kujdes kohën! Pyetje shtesë, deputete?

DONIKA KADA: I nderuar ministër, ju faleminderit për një përgjigje ashtu të përgjithshme. Unë dua t'ju them që çështja e njohjes së vendit shtet, është detyrë e të gjithëve dhe jo vetëm e një ministri të Jashtëm ose e Kryeministrit, është detyrë edhe përgjegjësi e të gjithë neve. Prandaj, unë nuk them që ndoshta ju personalisht nuk jeni takuar ose nuk keni realizuar disa takime, po puna nuk po shihet për shkak se ka ngecje, ministër, ka ngecje edhe ne po kërkojmë cilët janë ata hapa formal që janë ndërmarrë, në mënyrë që të vazhdojmë të ecim me një temp më të përshpejtuar sepse na duhet ta kemi njohjen edhe të 60 shteteve. Kërkojmë hapa konkretë, jashtë vizitave që ju personalisht i bëni, e që si duket nuk kanë sukses për shkak se njohja nuk po vazhdon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, mund ta shfrytëzosh kohen 2 minuta.

MINISTRI SKENDER HYSENI: Me gjithë respektin, zonja deputete, nuk mund të pajtohem që ka ngecje në procesin e njohjes, e aq më pak mund të pajtohem se është gjendja alarmante në procesin e njohjeve. Përkundrazi, trendi i njohjeve ka marrë një dinamikë të natyrshme pas shpërthimit të njohjeve menjëherë pas shpalljes së pavarësisë.

Unë nuk thashë dhe asnjëherë nuk e kam thënë që çështja e përfaqësimit të Kosovës, që ju po e përktheni me terminologji lobim, është e drejtë ekskluzive e ministrit ose e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Përkundrazi, e thashë që çështja e përfaqësimit të Kosovës është detyrë e të gjitha institucioneve të Kosovës dhe ne e mirëpresim angazhimin e të gjitha institucioneve të Kosovës në rrafshin e përfaqësimit institucional të Kosovës.

Sa u përket përpjekjeve për të fituar përkrahje për Kosovën në rrafshet e tjera jointucionale, është çështje e individëve, e grupeve dhe Ministria e Punëve të Jashtme, si institucion, as nuk do të autorizojë grupe të tilla ose ndërmarrje të tilla, as nuk do t'i pengojë. Përkundrazi, i nxitë të gjithë që mund të japin një fjalë në favor të njohjeve të mëtejme që do të vijnë dhe do të ketë shumë, ta bëjnë këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

50 minutat e paraparë për pyetje parlamentare u harxhuan. Nëse jeni të gatshëm ju, mund të vazhdojmë me pyetje, por ta zgjasim kohën. Unë dëshiroj t'ju pyes juve, sepse në dispozicion i kemi 50 minuta.

Urdhëro, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar, është e vërtetë që e kemi atë minutazhë, sipas Rregullores 50 minuta, por meqë i shohim kështu në portret të përbashkët Qeverinë sot, shpesh nuk kemi shans, unë i kisha lutur deputetët që të harxhohen të gjitha këto pyetje. Unë mendoj që e marrim edhe një gjysmë ore e jo më shumë, sa po shoh unë.

KRYETARI: Vazhdojmë. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Transportit dhe të Posttelekomunikacionit, z. Fatmir Limaj.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Gallapi apo Gollaku është trevë e më se 80 katundeve, që për shkak të shtrirjes së saj gjeografike, siç dihet shtrihet rreth kufirit me Serbinë, ka rëndësinë e veçantë strategjike. Por, nga qeveritë e mëparshme kjo trevë nuk u trajtua plotësisht si e tillë, për shkak se me vite të tëra nuk iu dha kujdes i merituar, sidomos në aspektin e infrastrukturës rrugore, për çka më se 90% e popullatës së saj tashmë janë shpërngulur nga atje. Pyetja: Është paraparë ndërtimi i tetë rrugëve që do ta nxirrnin Gallapin nga izolimi, por deri më tani ato nuk u konkretizuan. Cili është qëndrimi i kësaj Qeverie, respektivisht i Ministrisë së Transportit lidhur me këto rrugë, e ato janë: rruga Prapashticë-Glllogovicë, Krilevë-Strezoc, rruga e Desivojcës, e Poliçkës, rruga Tugjevc – Kapi, hapja e trasesë së rrugës Kapi-Tërstenë e gjatë rreth 40 km, e tëra rreth kufirit, rruga Bulaj-Krilevë, Artanë-Krilevë dhe rruga Koliç-Dyz. Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Ju faleminderit për pyetje, zoti deputet!

Gjatë vitit 2008, në rejonin e Gollakut, Ministria e Transportit është duke investuar në këto projekte: rehabilitimi i Rrugës Prishtinë-Mutivodë, pjesa Qemeli Kolaj – Koliç e cila do të përfundojë vitin e ardhshëm përfundimisht, në këtë vit investohet në gjatësi prej 10 km. Vlera e projektit e ka 1.480.500.

Rehabilitimi i rrugës Zajqec, Tugjec – Kapi në gjatësi prej 6.5 kilometra, vlera e projektit është 1.430.545 euro.

Ndërtimi i rrugës Hajkobillë – Zajqec, vazhdimi i projektit nga viti i kaluar, vlera e punëve që do të ekzekutohen në këtë vit është 467.000 euro.

Asfaltimi i rrugës, i cili pothuaj se ka përfunduar para dy ditëve, pritet vetëm pranimi teknik i kësaj rruge, asfaltimi i rrugës Strezoc-Krilevë, në gjatësi prej 5 kilometrave, vlera e projektit ka kushtuar 510.000 euro.

Vitin e kaluar ka përfunduar faza e parë e ndërtimit të rrugës qytet – Mramor, ndërsa gjatë këtij viti, është duke u realizuar faza e dytë dhe përfundimtare e këtij projekti dhe Ministria e Transportit ka ndarë mjete në vlerë prej 490,000 eurove. Vlera totale e këtyre investimeve në këtë zonë vetëm për vitin 2008 është 3.560.000 euro.

Rruga Shipashnicë – Desivojcë - Tërstenë, në këtë viti është paraparë të mirëmbahet në kuadër të mirëmbajtjeve të rrugëve. Sa i përket rrugëve, rruga e Desivojcës, rruga e

Poliçkës, rruga Bullaj - Krilevë, rruga Artanë – Krilevë dhe rruga Koliç - Dyz, këto janë në investime. Këto rrugë parashihen që të bëhen në periudhën ardhshme pas përgatitjes së dokumentacionit teknik dhe vlerës së paralogaritur të punëve nga kuvendet komunale.

Gjithashtu, dua të them se në këtë vit do të fillojë në fazën e parë të ndërtimit të këtyre rrugëve, ndërtimi i rrugës Slivovë - Viti e Marecit, në kuadër të Komunës së Prishtinës, dhe ndërtimi i rrugës Dheu i Kuq – Gllogovicë - Hajkobillë, gjithashtu në kuadër të Komunës së Prishtinës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë

DRITON TALI: Jo zoti Kryetar, zoti ministër ishte i qartë dhe nuk kam pyetje shtesë.

KRYETARI: Deputetja Luljeta Shehu, nga LDK-ja, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Pula.

LULJETA SHEHU: I nderuari Kryetar!

Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Arsyeja për pyetje është, sepse familjet e të pagjeturve, të dëshmorëve dhe familjet me asistencë sociale për shkak të pensioneve të ulëta që i kanë pasur, shumë e borxhit për rrymë elektrike prej pasluftës deri më 2007, nuk kanë pasur mjete financiare për ta paguar. Prandaj, pyetja është: Mundësia e shlyerjes së borxhit të rrymës për familjet e përmendura prej vitit 1999 deri në vitin 2007, me qëllim që prej vitit 2008 të fillohet të bëhet pagesa e rregullt e rrymës për familjet e përmendura. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA PULA: Ju faleminderit, zoti kryeparlamentar,

Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,

Pyetjen, të cilën zonja deputete Shehu e ka bërë, është shumë me rëndësi dhe i kushtohet një vëmendje të veçantë. Autoriteti ligjor që unë kam, nuk mund ta zgjidhë në një situatë aq të shpejtë dhe ta definojë këtë çështje. Mirëpo, mund t'ju jap një informatë se Qeveria vazhdimisht është duke i përcjellë familjet e varfra, familjet e dëshmorëve, familjet të cilët e kanë humbur kryefamiljarin, kështu që në kuadër të kësaj situate janë përcaktuar edhe familjet në kategori të caktuara. Në kuadër të këtyre kategorive të caktuara, Qeveria është duke i falur 500 kilovatë orë energji elektrike në muaj, që do të thotë se Qeverisë i kushton diku 357.000 apo 4.5 milion euro në vit.

Familjet të cilat janë të privileguara sa i përket kësaj situate, janë të obliguara të paguajnë faturën e rrymës vetëm për angazhimin e rrymës apo shfrytëzimin e rrymës të cilën e kanë mbi këta kilovat për të cilët ata janë të angazhuar.

Nëse kërkohet që të lirohen edhe nga kjo pjesë shtesë e këtyre buxheteve, apo të kësaj energjie të cilën e shfrytëzojnë, atëherë në fakt Qeveria me ministrinë përkatëse, si dhe

Kuvendi, duhet të bëjnë një analizë më të detajuar të kostos dhe t'i japin opsionet e mundshme sa u përket këtyre çështjeve. Ne, si ministri, jemi të angazhuar dhe vazhdimisht jemi në kontakt me familjet e dëshmorëve apo me të gjitha familjet që bëjnë pjesë në kategorinë e rasteve sociale, që t'iu ofrojmë ndihmën për kërkesat të cilat ata i kanë, në kuadër të mundësive të parapara.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!
Deputete, ke pyetje shtesë?

LULJETA SHEHU: Jo, ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Luljeta Shehu, nga LDK-ja, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.

Deputete, mund ta parashtroni pyetjen!

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit!

Pyetja është për ministrin e Arsimit. Me qenë se gjatë fushatës elektorale më 2007 keni premtuar se do të ketë rritje të pagave të punëtorëve të arsimit në Kosovë, pyetja është: A keni planifikuar si objektiv të veçantë në programet e MASHT-it që gjatë vitit 2008 do të ketë rritje të pagave për punëtorët e arsimit në Kosovë?

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Do të synoj që të jem i shkurtër dhe preciz në këtë pyetje. Do të ketë rritje të pagave. Vendimin do ta marrë Qeveria për rritje të pagave, përderisa Ministria e Arsimit do ta jetësojë, do ta implementojë projektin se si do të rriten pagat dhe rritjet do të ndodhin më 1 shtator të këtij viti. Buxheti është siguruar dhe buxheti është ndarë. Atë për të cilën kam dëshirë t'ju informoj si deputetë të nderuar të këtij Kuvendi, është që rritja e pagave do të jetë në të njëjtën kohë edhe reformë e sistemit tonë të pagave. Frustrimin më të madh që e kanë pasur arsimtarët në këto vitet e pasluftës ka qenë ai sistemi linear, sistemi dyz i pagave, kështu që do të ketë rritje të pagave në përputhje me shkallën e kualifikimit dhe në përputhje me përvojën që e ka çdo arsimtarë.

Gjatë muajit qershor dhe gjatë muajit korrik, Ministria e Arsimit, gjegjësisht inspektorët e Ministrisë së Arsimit, kanë bërë verifikimin e dokumenteve të 25 mijë arsimtarëve në tërë territorin e Kosovës. I falënderoj komunat për bashkëpunimin që e kemi pasur, dhe në përputhje me këto të dhëna që do t'i mbledhim, nga 1 shtatori do të ketë rritje të pagave për arsimtarë, e cila do të jetë një reformë e re e sistemit tonë të pagave, ku arsimtarët do të definohen si nëpunës shtetëror ose si shërbim profesional dhe civil.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

LULJETA SHEHU: Jo, faleminderit !

KRYETARI: Ju faleminderit edhe prej jush!

Deputeti Rrasim Selmanaj, nga AAK-ja. Pyetje për ministrin e Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati. Deputet, e keni fjalën!

RASIM SELMANAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

Me datën 17 nëntor 2007, në Junik, qytetarët e Junikut përmes votës së lirë fuqishëm i dhanë besimin e plotë Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për të qeverisur në këtë pilot njësi, ku AAK fitoi 49% të votave. Edhe pse LDK në zgjedhjet e fundit mori vetëm 23% të votave, ajo vazhdon të jetë në pushtet. Pyes ministrin e Pushtetit Lokal, zotin Sadri Ferati, pse dhe deri kur do të abuzohet me vullnetin e qytetarëve të Junikut?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SADRI FERATI: Ju faleminderit zotëri, i nderuar kryetar i Parlamentit.

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar a deputetë,

Sa i përket pyetjes së deputetit Selmanaj, siç dihet, me Rregulloren 2000/45 dhe 2000/30, në Kosovë ishin 30 komuna dhe po aq zona zgjedhore, dhe në po të gjitha këto zona zgjedhore ishin shpallur zgjedhjet. Pra, në nivel të komunës së Deçanit, nuk kishte zgjedhje të veçanta për pilot njësi. Në të 26 komunat u implementuan ato rezultate, ndërsa në 4 komuna është bërë vazhdimi i mandatit për strukturat ekzistuese. Tani, me hyrjen e Ligjit për vetëqeverisje lokale në fuqi, dhe të ligjit për kufijtë administrativ, Kosova do t'i ketë 38 komuna. 30 komunat ekzistuese, 5 komuna të reja dhe 3 pilotë njësi, të cilat dalëngadalë do të konvertohen nga pilot njësi në komuna me kompetenca të plota. Ne do të bëjmë çmos që t'i ndihmojmë të gjitha komunave ekzistuese në fuqizimin e tyre, si dhe në përgatitjen e implementimin e komunave të reja, me çka po bëhen përgatitje të fuqishme vazhdimisht, si dhe në ndihmesën që pilot njësitë vazhdimisht t'i ngrehin kapacitetet e tyre, në mënyrë që pas mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta, kur ato i shpallin institucionet e Kosovës, në pajtueshmëri me ligjet e Kosovës edhe ato ta kenë rastin që të marrin pjesë në zgjedhjet e lira dhe t'i instalojnë strukturat. Pra, nuk do të ketë asnjë ndryshim nga të gjitha kërkesat e shumta që i kemi, nga se kemi krijuar komuna legjitime. Ne do të vazhdojmë dhe kjo vlen për të gjitha komunat dhe për çdo pjesë të territorit të Kosovës. Tani kemi 30 komuna, vazhdojmë në 38 dhe këto mundësi të çfarëdo implementimi të votës së lirë dhe të vullnetit politik, do të bëhen në zgjedhjet e ardhshme të lira. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

RASIM SELMANAJ: Unë besoj se nuk ka vend në botë, përveç në këtë rast në Junik, që vazhdon të qeverisë një parti e cila i ka humbur zgjedhjet. Mendoj se kjo nuk është në rregull për faktin se Kosova tash është veç me Kushtetutë dhe kjo çështje nuk është më çështje e rezervuar e askujt. Unë kisha propozuar që ministri bashkë me Qeverinë të shkojnë atje dhe ta instalojnë qeverisjen e re, pra Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, e cila i ka fituar zgjedhjet përmes votave të lira të qytetarëve të Junikut. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ministër, ke përgjigje shtesë?

MINISTRI SADRI FERATI: Natyrisht, ne me shumë dëshirë do të implementojmë çdo vullnet të elektoratit dhe të qytetarëve, aty ku është krijuar ai. Po e përsëris, në pilot njësinë e Junikut nuk janë mbajtur zgjedhjet për komunë, për njësi të veçantë, janë mbajtur zgjedhjet për Deçan dhe tani, kur planifikohet që ai të shndërrohet në një komunë sikur edhe komunat tjera, do ta pret rastin e vet, do ta shpreh vullnetin dhe, natyrisht, me shumë kënaqësi do ta implementojmë.

Do ta përsëris edhe njëherë, në zgjedhjet e nëntorit të kaluar, më 17 nëntor, në zgjedhje kanë dalë 30 komuna në 30 njësi zgjedhore. Pra, këtu nuk është Juniku. Me shumë dëshirë ne do t'i ndihmojmë edhe Junikut si edhe komunave të tjera, do të mbahen zgjedhjet e lira dhe do të implementohen këto rezultate të gjitha dhe nuk do të lëvizim nga ky qëndrim për asnjë komunë të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

ARSIM REXHEPI: Përshëndetje, zoti Kryetar,

Kolegë dhe kolege deputetë,

Halli im është se procesi i privatizimit e ka shkatërruar tërësisht atë që dikur ka qenë ekonomia e Vushtrrisë. Në fabrikat ku më parë kanë punuar diku rreth 5000 e më shumë punëtorë, sot në to nuk punojnë as 300-400 veta, më së shumti 500, dhe të dy pyetjet, besoj që tjetra është në radhë, i drejtohen zotit ministër, Ahmet Shala.

Pyetja e parë: Fabrika “LLamkos”, në Vushtri, është një fabrikë me një traditë të bujshme afariste, nga e cila varet ndjeshëm ekonomia e Vushtrrisë dhe mirëqenia e qytetarëve të saj. Gjatë procesit të privatizimit, zoti ministër, Ju keni qenë udhëheqës i AKM-së në atë kohë dhe jeni mirë i informuar si kanë shkuar ato punë. Kjo fabrikë është privatizuar nga një investitor bullgar, tani janë paraqitur vështirësitë...

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën! Një minutë e keni... Zoti, deputet, ju lutem, paraprakisht e bën pyetjen, pastaj komento nëse të del kohë, por jo një herë komento një minutë ose dy e pastaj parashtro pyetjen. Mësoni njëfarë rregulle. Megjithatë, po e bëj një përjashtim dhe le të jetë i fundit. E bëni pyetjen që të përgjigjet ministri.

ARSIM REXHEPI... tani janë paraqitur vështirësi dhe konteste juridiko-pronësore me kualitet të ri për këtë fabrikë. Janë pretendime të një afaristi indian...

(Ndërhyrje, nuk dëgjohet për transkriptim)

...po kjo është pyetja. Ngadalë, çka po ndërhyni pa lidhje. Pyetjen jam kah e bëj. Aty janë dy veta, është një bullgar dhe një indian dhe tash nuk dihet, 500 vetë nuk kanë rroga, e ju po bëni hajgare, e bëni pyetjen, mos e bëni pyetjen. Lëreni këtë muhabet!

Zoti ministër, kush është pronar i fabrikës së “LLamkos”-it dhe çka po bëhet me këta njerëz? Po pra, se nuk e kam ditur unë çka quajnë pyetje...

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari deputet, mbase kjo pyetje do të duhej t'i adresohet Agjencionit Kosovar të Privatizimit tani, temë e cila do të shqyrtohet tani për anëtarët e Bordit, e cila është nën kompetencën e Agjencionit Kosovar të Privatizimit. Ndërmarrja është privatizuar me spinof special. Edhe unë jam i informuar që ai nuk i ka plotësuar investimet dhe jemi shumë të shqetësuar. Bordi i Agjencionit të Privatizimit të Kosovës i ka të gjitha kompetencat për të gjitha ato ndërmarrje të cilat nuk i kanë realizuar investimet e veta apo punësimin, ka të drejtë t'ia marrë mbrapa fabrikën dhe të ritenderojë. Do të jetë çështje e vendimit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit për ta udhëhequr këtë çështje, ndërsa Qeveria e Kosovës e mbështet çdo opsion i cili siguron punësim dhe siguron prodhim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputet, a ke pyetje shtesë?

ARSIM REXHEPI: Po, zoti Kryetar!

Zoti ministër, para se të zëni vend, cilat janë ingerencat e Ministrisë që e drejtoni ju? Cilat ishin ingerencat, unë atë pyeta, dhe si t'i shpëtojmë ata njerëz dhe t'i nxjerrim nga ajo situatë e mosdijes se çka do të bëhet me ardhmërinë e tyre? Kjo ishte.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri Shala.

AHMET SHALA: Qeveria e Kosovës, të drejtat dhe autorizimet e plota në Agjencionin e Privatizimit të Kosovës do t'i delegojë me vendimin tuaj, të nderuar deputetë, sot faktikisht, dhe to t'ju kisha lutur paraprakisht që ta përkrahni këtë që shumë privatizime të cilat kanë ngecë në proces dhe shumë kontrata që kanë mbetur pa u nënshkruar, të marrin veprime.

Të gjitha kompetencat do t'i ketë Bordi i Agjencionit të Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Lus deputetin Arsim Rexhepi që ta bëjë pyetjen dhe mos ta shpenzojë kohën. Pyetje për ministrin e Transportit dhe të Posttelekomunikacionit, zotin Fatmir Limaj. Deputet, e keni fjalën!

ARSIM REXHEPI: Zoti ministër, Kosova ka një numër të madh mërgimtarësh, të cilët e kanë ndihmuar dhe vazhdojnë ta ndihmojnë Kosovën. Gjatë ardhjes së tyre në Kosovë, përveç kufijve të tjerë dhe vështirësive që i kanë, edhe në kufirin e Kosovës iu paraqitet një vështirësi i llojit të veçantë. Njëra nga këto pengesa, do të thotë, është pagesa e obligueshme prej 50 eurosh për sigurimin e automjeteve, përkundër faktit se të gjithë ata posedojnë sigurimet internacionale të ashtuquajtura - kartelë e gjelbër.

Zotëri ministër, tash kur Kosova është shtet i njohur ndërkombëtarisht dhe do të duhej t'iu përgjigjej marrëveshjeve që iu nënshtrohet në marrëdhëniet multilaterale, po e shkurttoj pyetjen, a do të ishte, a nuk keni menduar që ta hiqni këtë pagesë dhe mërgimtarët të paguajnë një shtesë për rrugët. Kjo ishte pyetja. A keni diçka në këtë plan?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën, nëse e keni kuptuar pyetjen!

MINISTRI FATMIR LIMAJ: I nderuar zoti deputet, unë ju falënderoj për pyetjen, për çështjen të cilën ju e keni ngritur. Këtu është një problematikë që më tepër i përket Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Autoritetit Qendror Bankar, e jo Ministrisë së Transportit dhe Posttelekomit. Sido që të jetë, shumën të cilën ju e potenconi paguhet për çdo automjet të huaj që hynë në Kosovë, si sigurim kufitar, për arsye se Kosova fatkeqësisht ende nuk është anëtare e klubit dhe sistemit të kartelës së gjelbër, të quajtur grin - kartë. Jo vetëm ata që hyjnë, por edhe vetë qytetarët tanë, ju e dini, kur udhëtoni në vendet tjera të Bashkimit Evropian, paguani një sigurim të veçantë, një shumë jashtëzakonisht të shtrenjtë. Përderisa Kosova të jetë pjesë e këtij sistemi, që duhet të jetë një njohje reciproke dhe kartelat e gjelbra duhet t'i njihen edhe të Kosovës në vendet tjera dhe besoj se kjo duhet të gjendet tash në një marrëveshje reciproke përmes institucioneve përkatëse.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputet, ke pyetje shtesë?

ARSIM REXHEPI: Jo, nëse nuk është kjo në ingerencat e Ministrisë që e drejton zoti Limaj, atëherë nuk kam kujt t'ia bëj.

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

ARSIM REXHEPI: Zoti ministër, Shala,
E njëjta që u tha për "Llamkos"-in, qëndron edhe për fabrikën e "Vushteks"-it. Aty kanë punuar rreth 3000 veta, para se kjo fabrikë përmes dhunës serbe të fillonte shkatërrimin e saj. Çështja është se aty janë nënshkruar marrëveshje. Mendoj se po përsëritet ajo çka u tha, se kjo fabrikë është shndërruar në një depo të patateve e ku ta dijë unë, të mallrave me shumicë, mënela, tranguj e çka të dush, por jo në destinacionin që e implikon marrëveshja e nënshkruar për privatizim. Mendoj, pyetja është, si të veprohet tutje me fabrika të tilla? Ju më herët veç e dhatë përgjigjen, kështu që nuk ka nevojë për përgjigje.

KRYETARI: Unë, vetëm një vërejtje po ia jap administratës. Nëse deputeti ka bërë koment dhe jo pyetje, pyetja të mos hyjë në rend dite. Ju lutem, pyetje nuk ke bërë. Urdhëro, zoti Shala, përgjigju nëse e ke kuptuar pyetjen!

AHMET SHALA: Pyetja vërtet ishte komplekse dhe nuk e kuptova, por sido që të jetë, më lejo që të përgjigjem.

Ndërmarrja "Vushteks", sa e di unë, edhe pse thashë këto pyetje të gjitha do të duhej t'i adresohen Agjencionit Kosovar të Privatizimit, por nga informatat që unë i kam, aq sa më kujtohen, ndërmarrja "Vushteks" është shitur me spinof të rregullt dhe blerësi duhet të reagojë konform kërkesave të tregut. Është çështje e organeve komunale se a e lejon një ndërmarrje për ta ndërruar destinacionin e vet apo jo. Nuk jemi në ekonominë socialiste kur Qeveria duhet t'i detyrojë ata të prodhojnë tekstil. Tekstili ashtu dhe kështu është pjesë e vdekur. Të gjitha fabrikat në Evropë pothuaj se janë mbyllur dhe kanë kaluar në Angli dhe Kinë. Kështu që, në qoftë se ne dëshirojmë ta kthejmë atë, atëherë jemi gabim në filozofinë e mendimit, ndërsa sa i përket ndërrimit të

destinacionit, është kompetente komuna. Ajo fabrikë është privatizuar me spinof të rregullt. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Keni pyetje shtesë? Veç ta keni parasysh kur të bëni pyetje se në Kosovë sistemet kanë ndërruar.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti. Ju lutem, pyetjet ia drejtoni një ministri. Zoti Pajaziti nuk është, atëherë le të përgjigjet zoti Ahmet Shala pasi është këtu.

DRITON TALI: Këtu vetëm njërin e kemi, zoti Kryetar. Pyetja ka të bëjë me kompetencat e të dy ministrive. Ka të bëjë me kontrabandën që po zhvillohet në Veri të Kosovës. Shumë mallra, siç dihet, futen në Kosovë ilegalisht, për çka Buxheti i Kosovës po humbë miliona euro. Nga mallrat kontrabandë veçohen derivatet e naftës, nga të cilat llogaritet që Buxheti ka humbur më se 8 milion euro për këta muaj, për të cilat po flitet.

Pos tjerash, tani ashikare shiten produktet e naftës në dy pompat ilegale të benzinës në Mitrovicë, pa i penguar askush. Këto pompa, për shkak të çmimit të ulët që e ofrojnë, janë bërë shumë të popullarizuara për shumë kosovarë, të cilët pa përtesë udhëtojnë anekënd Kosovës për t'u furnizuar me derivate të lira. Pse Qeveria e ka lejuar dhe po e lejon një anomali të tillë groteske? Kur mund të presim nga Qeveria që të ndërmarrë diçka konkrete dhe çfarë konkrete do të ndërmarrë për ta ndaluar këtë marrëzi? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHME SHALA: Ju faleminderit, i nderuari deputet!

Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, përkatësisht me KFOR-in dhe institucionet e pranishme ndërkombëtare në Kosovë, ka kërkuar me urgjencë dy gjëra, ose të mbyllet kufiri për tregti komerciale, ose të vendosen doganierët në pjesën veriore. Të dy opsionet janë duke u shqyrtuar. Hapat konkretë në këto dy, tri javët e ardhshme janë rivendosja e kamerave të cilat ishin shkatërruar apo djegur dhe ne kemi alokuar një buxhet prej gjysmë milioni eurosh, nëse ju kujtohet, me lejen tuaj, po ashtu. Ato do të vendosen në mënyrë që të jetë hapi i parë për të bërë të gjitha përcjelljet e lëvizjeve të kontrabandistëve.

Hapi tjetër është që, fatmirësisht, Ligji mbi procedurat e administratës tatimore tanimë ka kaluar, besoj se parlamenti në dëgjim të parë, diku në shtator do ta aprovojë, ku Administrata Tatimore do të ketë shumë fuqi më të madhe për t'i konfiskuar prodhimet që nuk kanë prejardhje. Dogana, përkatësisht Administrata Tatimore dhe Policia, në grupe mobile janë duke u përpjekur për ta zvogëluar dëmin. Dëmi mbase nuk do të zvogëlohet 100% edhe pasi të vendosen të gjitha ato, për shkak të vetë disponimit të shtetit fqinj atje, por besoj që si procedurë ne e kemi shumë të qartë se çfarë do të bëjmë në afat të shkurtër, në afat të mesëm dhe në afat të gjatë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pyetje shtesë?

DRITON TALI: Unë, zoti ministër, i ceka në mënyrë konkrete dy pompat që tregtojnë atje, pa i penguar askush. Janë në fushë, shihen nga çdo kush, janë shumë të frekuentuara, madje duhet të pritët, ashtu siç i kam informatat, me orë për t'u furnizuar me derivate të naftës. Mendoj se këtu nuk duhet fort të filozofojmë, por duhet që ligji të funksionojë, andaj edhe e kam pas bërë pyetjen për ministrin e Punëve të Brendshme, për shkak se mendoj që është kompetencë e tij. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në fakt, nuk pati pyetje shtesë.

Deputeti Armend Zemaj, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Zoti deputet, e keni fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, kryetar! Po shkojmë me pak marketing, kështu. Zoti ministër, pasi që pyetja ime, ndoshta për shkak të afatit kohor, nuk e di se e kam lexuar javën e kaluar, ne edhe veç e kemi në procesverbal. Është fjala për numrin e studentëve që Universiteti i Prishtinës e ka paraparë për këtë viti për regjistrim, ndërsa Ministria që ju e drejtoni, e ka lejuar një numër shtesë, do me thënë prej 8055 sa i ka propozuar Senati, ju keni lejuar numrin prej 1110 studentë. Shqetësimi im ka qenë se në çka është bazuar vendimi i juaj, duke marrë parasysh kushtet që ofron tani për tani Universiteti i Prishtinës. Do me thënë, të gjitha këto kanë të bëjnë me kushtet, objektet që i kemi dhe numrin kaq të madh të studentëve. A kemi këtu ndoshta ndërhyrje në pavarësinë e Senatit të Universitetit të Prishtinës?

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën! I keni 3 minuta për përgjigje.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit shumë, zoti Kryetar! I nderuari zoti deputet, ju kërkoj falje për mungesën time javën e kaluar. Unë synoj që të jem vërtet direkt në përgjigje. Nuk është ndërhyrje në punën e Senatit, meqë në çdo vend të botës, e në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, është Qeveria ajo e cila e cakton kuotën sa i përket numrit të studentëve në fushën e arsimit të lartë, në fushën e arsimit të lartë publik. Ndërsa, arsyet të cilat ne na kanë sjellë që ta rrisim numrin e studentëve edhe për 3000, janë arsye konkrete, të prekshme dhe që burojnë nga nevojat e Kosovës. Ju e dini se Kosova llogaritet si shoqëria më e re në Evropë, ndërsa pjesëmarrja në arsimin e lartë është më e ulëta në rajon dhe në Evropë. Prandaj, ne jemi të interesuar që vërtet ta rrisim pjesëmarrjen në arsimin e lartë. Analizat që merren me arsimin e lartë, konstatojnë që nëse në një vend perëndimor, në Evropë ose në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një i ri e ndërprente shkollimin e lartë, humbja e atij shtetit është 200.000 mijë ose 300.000 dollarë në viti për mos vazhdimin e arsimit të lartë. Ndërsa, ne kemi një situatë të kundërt.

Arsyeja e dytë është që ne kemi vendosur që ta rrisim numrin e studentëve në shkencat të cilat Kosovës i sigurojnë rritje ekonomike. Për shembull, kemi sugjeruar që të ketë rritje në Fakultetin Teknik, në Fakultetin e Bujqësisë, në shkencat aplikative natyrore. Të gjitha këto shkenca sigurojnë rritje dhe zhvillim ekonomik.

Arsyeja e tretë është që e kemi hequr kuotën për studentët që vijnë nga Presheva dhe Mali i Zi dhe jemi të interesuar që kjo pjesë, e cila banohet nga shqiptarët, vërtet të mos diskriminohen në Universitetin e Prishtinës për kuota.

Arsyeja e katër është që Ligji për maturën dhe strategjia për arsimin e lartë, të miratuar në vitin 2005, edhe trendet evropiane parashohin që të ketë liberalizim të numrit të studentëve, me fjalë të tjera, të mos ketë kuota fare, kështu që ne nuk e përjashtojmë mundësinë që gjatë dy viteve të ardhshme me implementim të strategjisë për arsimin e lartë, do t'i heqim komplet edhe kufizimet në numër.

Sa u përket kushteve, ju e dini se Universiteti i Prishtinës punon deri në orën 15,00 pas dite, në universitetet perëndimore seminarët dhe ligjëratat më të mira i fillojnë në ora 7 – 8, kështu që hapësirë ka, buxhet ka, buxheti që e ka Universiteti i Prishtinës për këtë vit nga Ministria është 12 milion, ndërsa nga të hyrat vetanake është 9 milion. Me 20.000.000 besoni që mund të organizohet një proces arsimor jo për 11.000 studentë, po për 15.000 studentë.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti ministër!
Deputet, do ta vazhdoesh marketingun?

ARMEND ZEMAJ: Jam pozitiv, unë nuk kam nevojë për marketing.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputeti Agim Veliu, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencë dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputeti Agim Veliu e ka fjalën.

AGIM VELIU: Ju faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Është thënë, madje është përsëritur disa herë, se këtë vit Kosova për herë të parë do të organizojë provimin e maturës, me Ligjin për provimin e maturës, që është aprovuar në këtë Kuvend.

Pyetja ime është për ministrin e Arsimit, zotin Enver Hoxhaj, pse pas publikimit të rezultateve të testit të maturës, ministri ka marrë vendim për uljen e pragut të kalueshmërisë nga 50 në 45%, siç e thotë Ligji.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Zoti deputet Veliu,

Po synoj që përsëri të jem i shkurtër. Arsyeja e parë është që ne Ligjin e kemi miratuar, i cili është hartuar nga ju sa keni qenë në Ministri të Arsimit, e që është ndër ligjet më të mira që ka Kosova. E kemi miratuar para tre muajsh dhe, do të thotë, ka qenë një hapësirë shumë e ngushtë kohore, por ne kemi bërë përpjekje maksimale që maturën mos ta organizojmë me udhëzime administrative të ministrit, por me Ligj, i cili është miratuar nga vetë deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Arsyeja e dytë është që në Kosovë nuk ka pasur dhe nuk ka edhe më tutje traditë të maturës shtetërore, që nxënësit, prindërit, arsimtarët, familjet të informohet paraprakisht për atë se çka është matura. Matura është një vlerësim i jashtëm. Shkollat e kanë vlerësimin e brendshëm, ky është një vlerësim i jashtëm. Prandaj, meqë kjo kulturë është e re, ne e kemi parë të arsyeshme që ta ulim pragun edhe për 5%.

Arsyeja e tretë është që disa nga shkollat në Kosovë, dhe unë si ministër jam i detyruar që t'ju informoj saktësisht për gjendjen në arsim, nuk kanë punuar me plan-programet të cilat i ka miratuar Ministria e Arsimit, mirëpo kanë mbajtur mësim me disa tekste si iu ka tekur atyre dhe nxënësit kanë qenë thjeshtë viktimë të moszbatimit të plan-programeve.

Arsyeja katërt është që në shumë shkolla profesionale nuk ka tekste shkollore, dhe ne do të bëjmë përpjekje që të gjitha shkollave profesionale, gjatë këtij mandati t'iu ofrojmë tekste shkollore.

Arsyeja e pestë është një arsye pothuaj pragmatike. Kufiri i vijës se sa studentë duhet të pranohen, është çdoherë vendim i Qeverisë. Ne do ta kemi 50% sivjet, do ta kemi edhe në dy vitet e ardhshme. Në momentin kur e liberalizojmë regjistrimin e studentëve, pragu mund të jetë 30%, pragu mund të jetë 40%, pragu mund të jetë 70%, lëviz. Varet prej asaj se sa Qeveria vendos të ketë njerëz që shkojnë në arsimin e lartë. Përndryshe, kam dëshirë t'ju informoj që në shumicën e vendeve të rajonit, pragu i kalueshmërisë është 30%, në Kroaci është 40%. Kosova kësaj here e ka pasur me standarde evropiane 50%. 50% është në Evropë, 50% është edhe në Kosovë, kështu që ka qenë, sinqerisht, sukses.

Me uljen e pragut për 5%, ne kemi mbërri që t'iu ofrojmë edhe 3000 studentëve, edhe 3000 maturantëve mundësinë që ta ushtrojnë të drejtën e tyre në arsimin e lartë, dhe sidomos nga qytetet e vogla. Për shembull, pragu i kalueshmërisë në Prishtinë ka qenë 60%, në Kastriot, në Obiliq ka qenë vetëm 9%, kështu që prej kësaj uljes së pragut kanë përfituar sidomos disa zona rurale të cilat duhet ta kenë të drejtën që ta ushtrojnë në arsimin e lartë. Këto kanë qenë ato arsyet kryesore.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputet, ke pyetje shtesë?

Fjalën e ka deputeti Agim Veliu.

AGIM VELIU: Ju faleminderit, kryetar! Në fakt, nuk kam pyetje, por më duhet ta bëj një konstatim. Është fakt se këtë vit provimi i maturës, i gjithë procesi deri në shpalljen e rezultateve është organizuar në bazë të Ligjit për provimin e maturës dhe ka qenë një organizim shumë i mirë nga ana e Ministrisë, për çka e përgëzoj ministrin. Mirëpo, më duhet të konstatoj që pas shpalljes së rezultateve ministri me vendim e ka shkelë germën e Ligjit, kështu që ky është një konstatim i imi. Ligji e thotë: pragu i kalueshmërisë është 50, ministri me vendim e ka ulur pragun nga 50 në 45, për çka unë konstatoj me keqardhje se është shkelë Ligji edhe i sugjeroj ministrit që t'i respektojë ligjet, dhe shtrohet pyetja a ka të drejtë ministri ta ndryshojë me vendim ligjin i cili është aprovuar në Kuvendin e Kosovës?

KRYETARI: Ju faleminderit! Konsideroj se ministri është përgjigjur në këtë çështje. Vazhdojmë me pyetjen e parafundit.

Deputetja Myrvete Pantina, nga LDK-ja, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Myrvete, mund ta bëni pyetjen.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit!

Qytetarët e Vushtrrisë janë shumë të brengosur me gjendjen aktuale të fabrikës së llamarinës së zinkuar “Llankos” në Vushtri. Kjo është arsyeja që më ka shtyrë që edhe unë të merrem me këtë problem. Është fakt se tani e sa muaj kjo ndërmarrje gjendet në një situatë të rëndë. Është ndaluar prodhimi, punëtorëve iu janë zvogëluar pagat, madje muajt e fundit nuk kanë marrë fare paga. Ekziston frika se punëtorët mund të largohen nga puna, nuk dihet kush është pronari i vërtetë. Flitet se janë dy pronarë.

Zoti ministër, cili është pronari i vërtetë i fabrikës dhe pse është toleruar mospërbushja e obligimeve të tij ndaj fabrikës? Ju faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Konsideroj, zonja deputete, të nderuar deputetë, konsideroj se unë u përgjigja, po më lejoni të përsërisë faktikisht. Autoriteti i vetëm që ka të drejtë juridike për të sanksionuar një blerës gjatë spinofit special për mosrealizimin e obligimeve të veta, në këtë rast edhe të fabrikës së llamarinës, pra, është Agjencioni Kosovar i Privatizimit tani, i cili, do t’ju kisha lutur juve paraprakisht, kur të vjen në rend dite, t’i përshpejtojmë procedurat për aprovimin e anëtarëve të Bordit, në mënyrë që këta të kenë mundësi t’i zbatojnë ingerencat.

Komisioni Evropian është zotuar që në tre vitet e ardhshme të financojë gjithë stafin lokal të Agjencionit të Privatizimit të Kosovës, pra mbi 200 veta, dhe ata do të jenë që do ta zbatojnë Ligjin, ndërsa ne si Ministri e Ekonomisë dhe Financave, së bashku me Qeverinë e Kosovës, do të bëjmë gjithçka që është e mundur që të krijojmë hapësirë të volitshme, joshëse për investitorët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë?

Ju faleminderit! Pyetja e fundit, deputetja Suzan Novobërdaliu, AKR, pyetje për ministren e Energjetikës dhe të Minierave, zonjën Justina Pula.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Problemet e KEK-ut, reduktimet me energji elektrike, i dimë të gjithë që nga vitet e pasluftës. Në njërën nga gazetat ditore keni deklaruar se, citoj: “Sikur të kishim ditur që gjendja në KEK është kaq e keqe, nuk do t’i kishim dhënë premtimet që i kemi dhënë”. A do të thotë kjo që ju po e pranoni dështimin real në furnizimin me energji elektrike për qytetarët, në veçanti duke ndikuar në përkeqësimin klimës së investimeve ndërkombëtare si parakusht për zhvillim ekonomik dhe se ju, pa e ditur gjendjen reale, keni dhënë premtime të kota të tipit 24 orë rrymë elektrike?

KRYETARI: Ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA JUSTINA PULA: E nderuara deputete, është e vërtetë se kam deklaruar dhe këtë me plotë sinqeritet. Ju e dini se situata në sektorin e energjisë është e vështirë dhe do të vazhdojë të jetë e vështirë për një periudhë afatgjate.

Është e ditur se gjendja në sektorin e energjisë nuk mund të përmirësohet në një periudhë shumë të shkurtër. Të gjitha investimet të cilat bëhen në këtë sektor, manifestohen pas

disa muajve apo pas disa viteve. Prandaj, pasi që e kemi analizuar gjendjen aktuale në sektorin e energjisë, kemi konstatuar se ka shumë projekte të cilat është dashur të fillohet dhe nuk kanë filluar, që do të thotë se situata energjetike është e vështirë dhe momentin që ne do të investojmë apo do të fillojmë me projektet të cilat kanë qenë të planifikuara dhe i kemi planifikuar në këtë periudhë, do të manifestohen pas dy viteve apo më shumë viteve. Qeveria ka bërë veprime të duhura, duke dhënë donacione dhe duke planifikuar edhe kredi të mëdha, diku mbi 80 mijë euro për të filluar projekte të cilat është dashur të fillohen në Qeverinë e kaluar.

Konkretisht do të flas për dy projekte, të cilat janë shumë aktuale dhe për ne janë shumë të rëndësishme që të rumbullakohen apo të finalizohen në fund të vitit që të kemi një situatë energjetike apo të kemi energji elektrike të duhur. Ky është projekti i Sitnicës, i cili ka filluar në janar të vitit 2008, i cili projekt është paraparë në disa vite, po them vitin e kaluar se duhet të fillojë në një periudhë shumë të shpejtë, duke e ditur se situata në Minierën e Bardhit, të Mirashit është në përfundim. Gjithashtu e kemi edhe....

KRYETARI: Koha është harxhuar. Mund ta vazhdoni në pyetjen shtesë.
Ka pyetje shtesë, deputete?

SYZANE NOVOBRDALIU: Po zoti Kryetar, ju faleminderit!
Sa do të jenë të besueshme deklaratimet tua për qytetarin e Kosovës, kur ju keni dëshmuar se nuk keni qenë të aftë ta studioni gjendjen reale në KEK dhe keni lëvizur nga premtimet e dhëna në fushatë?

KRYETARI: Vazhdo përgjigjen ministre. Tani e keni radhën për t'u përgjigjur, 2 minuta.

MINISTRJA JUSTINA PULA: Unë isha shumë e qartë. Projektet janë paraparë më 2005, 2006 dhe është dashur të fillojnë, të realizohen më 2007, eventualisht 2005. Asnjë prej këtyre projekteve nuk kanë mund të realizohen. Ne jemi bazuar në kuadër të të dhënave të cilat i kemi pasur si dëshmi se ka projekte dhe duhet të fillojnë. Asnjë prej këtyre projekteve nuk ka filluar, që do të thotë se ne jemi duke filluar t'i implementojmë projektet dhe këto projekte do të manifestohen në vitin 2010 apo 2008...

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!
Me këtë përgjigje të fundit, sot i kemi harxhuar të gjitha pyetjet që i janë drejtuar Qeverisë. Për seancën e ardhshme mund të kemi vetëm pyetje të reja, kurse të vjetrat janë harxhuar, përveç një pyetje që është tërhequr nga deputetja Kada, që ka qenë për ministrin e Shërbimeve Publike.

Nëse jeni dakord, 15 minuta pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Vazhdojmë punën e seancës.
Në sallë janë 67 deputetë dhe mund të vazhdojmë punën.

Shqyrtimi i pikës së katërt të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Adminsitratë Lokale dhe Media lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës**

Miratimi, në parim, i këtij projektligji është bërë më 2 qershor 2008.

Ndërkohë, Qeveria ka kërkuar që Projektligji të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit.

Komisioni funksional për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media e ka shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Po ashtu, edhe Kryesia e Kuvendit e ka mbështetur kërkesën e Qeverisë.

Rekomandimi i Komisionit, së bashku me kërkesën e Qeverisë, iu është shpërndarë deputetëve.

Nëse jeni dakord, do të shkojmë drejtpërdrejt në votim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Në sallë janë 74 deputetë.

Konstatoj se me 58 vota „për“, 1 „kundër“ dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për shërbimet publike, adminsitratë lokale dhe media për tërheqjen e Projektligjit për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës nga procedura e mëtejme e shqyrtimit.

Faleminderit!

Pika e pestë:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shqyrtimit të Projektligjit për punën**

Miratimi, në parim, i këtij projektligji është bërë më 2 qershor 2008.

Ndërkohë, Qeveria ka kërkuar që Projektligji të tërhiqet nga procedura e shqyrtimit.

Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Po ashtu, nga Kryesia e Kuvendit është mbështetur kërkesa e Qeverisë.

Rekomandimi i Komisionit, së bashku me kërkesën e Qeverisë, iu është shpërndarë deputetëve.

Procedura është e njëjtë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatoj se me 65 vota „për“, asnjë „kundër“ dhe 7 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për tërheqjen e Projektligjit për punë nga procedura e shqyrtimit.

Faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me kërkesën e Qeverisë për tërheqjen nga procedura e shpalljes së Ligjit për sigurimin shëndetësor**

Miratimi i këtij ligji është bërë më 22 shkurt 2007, por nuk është shpallur nga PSSP.

Ndërkohë, Qeveria ka kërkuar që Ligji të tërhiqet nga procedura e shpalljes.

Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e ka shqyrtuar dhe përkrahur kërkesën e Qeverisë.

Po ashtu, edhe Kryesia e Kuvendit e ka mbështetur kërkesën e Qeverisë.

Rekomandimi i Komisionit, së bashku me kërkesën e Qeverisë, iu është shpërndarë deputetëve.

Vazhdojmë me procedurën e njëjtë. Lus deputetët dhe regjinë të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Ju njoftoj se në sallë janë 80 deputetë.

Konstatoj se me 65 vota „për“, 1 „kundër“ dhe 8 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për tërheqjen e Ligjit për sigurimin shëndetësor nga procedura e shpalljes.

Pika e radhës është:

- **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

Të nderuar deputetë,

Në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Qeveria ka parashtuar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Sipas nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kuvendi i Kosovës do të emërojë 5 drejtorë, duke përfshirë 1 përfaqësues nga një komunitet joshqiptar si dhe kryetarin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës dhe do të përcaktojë njërin nga të emëruarit që të shërbejë si kryetar i Bordit.

Vendimi i Qeverisë, së bashku me biografitë e kandidatëve, iu janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të arsyetojë propozim-vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si dhe të propozojë njërin prej tyre për kryesues të Bordit.

AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër, zëvendësministra dhe kolegë të tjerë,

Me hyrjen në fuqi të Ligjit mi Agjencionin Kosovar të Privatizimit shtrohet nevoja imediate për funksionalizimin e këtij institucioni të rëndësishëm për vazhdimin dhe përmbylljen e procesit të privatizimit.

Komisioni Evropian, fatmirësisht, ka ofruar ndihmë financiare në 3 apo 4 vitet e ardhshme për t'i mbajtur diku afër 200 punëtorë të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, normalisht me konkurrim, me ndihmë financiare për afër 4 milion euro në vit për 3 vitet e ardhshme dhe konform pakos së Ahtisarit ka emëruar 3 anëtarë të Bordit nga 8 sa duhet të jenë. Prandaj, 3 anëtarë, konform pakos së Ahtisarit i ka emëruar ICR dhe 5 anëtarë të tjerë Qeveria e Kosovës i ka propozuar dhe i ka aprovuar në Qeveri për t'i proceduar, konform Ligjit, në Parlament.

Anëtarët e propozuar nga ana e Qeverisë, ku 4 prej tyre kanë shërbyer deri më tani si anëtarë të AKM, janë Dino Hasanaj, i propozuar kryesues i Bordit, Fadil Ferati, Haxhi Arifi, përfaqësues i BSPK, Slllobodan Petroviq, Bahri Shabani. CV-itë e të gjithë këtyre anëtarëve janë të bashkëngjitura në material dhe kërkoj nga ju, të nderuar deputetë, që të apromoni këta anëtarë për Bord të AKP në mënyrë që ky institucion të vazhdojë të funksionojë konform ligjit dhe t'i adresojë disa nga çështjet të cilat u parashtruan me shumë të drejtë nga ana juaj para pak minutash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të nderuar,

Çështja e Bahri Shabanit duhet sqaruar. Ju e dini mirë çështjen e ligjit, dy nga sindikatat nuk mund të vijnë në këtë Bord, andaj ju lusim paraprkishtë të na sqaroni çështjen e Bahri Shabanit dhe pastaj të deklarohe mi, gjithsesi, për këtë çështje.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit!

Bahri Shabani ka paraqitur me shkrim kërkesë, përkatësisht vendim nga ana e KSLK-së Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila është protokolluar dhe dërguar më 15.7.2008, në të cilën deklaron se ka ngrirë dhe do të heq dorë nga të gjitha funksionet e veta në KSLK për të ushtruar funksionin e vet, ndërsa Qeveria e Kosovës e ka konsideruar si përfaqësues ekspert, e jo si përfaqësues i KSLK.

Në bazë të Ligjit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, vetëm një përfaqësues i sindikatës mund të jetë dhe ai është BSPK-a ndërsa anëtarët e tjerë do të shërbejnë si profesionistë, duke përfshirë edhe një përfaqësues të komunitetit serb. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dëgjuat sqarimin. Vazhdojmë sipas radhës. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e ka fjalën Ramë Buja.

RAMË BUJA: Nëse Bahri Shabani vërtet mund të shkarkohet nga ajo përgjegjësi që kishte dhe vërtet e ka dëshmuar atë se mund të jetë si ekspertë, atëherë, natyrisht, si Grup Parlamentar ne e mbështesim.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Lutfi Haziri, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së, e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ju paraqitët nenin 12, Kreu 3 të Ligjit për Agjencionin e Privatizimit. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka mbështetur edhe kërkesën e zotit Buja për sqarim rreth kandidatit të pestë. Natyrisht, ne mbështesim emërimin e Bordit, funksionalizimin e Bordit dhe ecjen përpara në këtë fushë shumë të rëndësishme. Kërkesë shtesë pak a shumë do të ishte për mua që ministri Shala edhe një herë të na sigurojë ne që zoti Bahri Shabani ka dhënë dorëheqje nga ajo detyrë dhe përfaqësuesi i vetëm, sipas Ligjit, i cili është shumë i qartë, mbetet përfaqësuesi i sindikatës me emër dhe mbiemër, sipas propozimit të Qeverisë, që në këtë rast është respektuar.

Pjesën tjetër të angazhimit tonë, Grupi Parlamentar sigurisht nuk ka dyshim, e mbështet në tërësi dhe kërkon që të funksionalizohet sa më shpejt.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar ministra, Kryeministër,

Të nderuar kolegë,

Ne sikur jemi mësuar me ngrirje dhe shkrirje të funksioneve. Në asnjë vend ligji nuk e thotë se dikush mund ta ngrijë funksionin në një organizëm. Zoti Shabani është kryetar i Konfederatës të Sindikatave të Lira të Kosovës dhe pavarësisht nëse e ngrinë ose jo funksionin e tij, nuk mund të jetë anëtar i këtij bordi me gjithë nevojën që ka Kosova dhe Agjencioni Kosovar për Privatizim që të kompletuar, andaj zoti Shabani nuk e ka vendin në këtë Bord përderisa është kryetar i Konfederatës së Sindikatave. Nëse ai jep dorëheqje, është krejt çështje tjetër, por ligji nuk e thotë që sa herë që do njeriu, ta ngrijë funksionin dhe, sa herë që i nevojitet, ta shkrijë funksionin. Ne, pavarësisht...Po më duket që ministri e sqaroi, por tha që është ngrirë funksioni dhe Kuvendi dhe ligji nuk parasheh askund që të ketë ngrirje të funksioneve që i kanë.

Prandaj, si Grup Parlamentar, nuk mund ta mbështesim në këtë formë këtë propozim të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Pa dashur të përsëris atë që e tha parafolësi, edhe ne mendojmë njëjtë, sepse i kemi dy përfaqësues të sindikatave dhe është bërë e qartë se përfaqësuesi i dytë, zoti Shabani, është i nominuar nga Qeveria e Kosovës dhe është plotësisht legjitime në këtë variant, por prapë se prapë kemi kontradiktë e cila lidhet me ligjin, në kohën kur kërkojmë

zhvillim ekonomik, rritje ekonomike e tjera, e tjera dhe kemi dy përfaqësues të sindikatave. Ne nuk besojmë se kjo është mënyrë për t'i arritur ato që janë premtuar.

Çështje tjetër është se është thënë se bordet do të jenë jo politike dhe profesionale. Ne mendojmë se ky Bord është politik. Prapë se prapë, në rregull, nëse është politik, por është në kundërshtim me atë që është thënë më herët. Nuk do të kishte pasur problem, në parim, sikur të mos ishin thënë gjërat më herët. Dhe, e fundit që është, nuk është profesional. Ne nuk besojmë se ky bord është profesional. Këtu në Kuvendin e Kosovës janë të ulur shumë profesionistë dhe shumë më të zotët se të gjithë anëtarët të cilët janë propozuar në këtë listë. Në fund të fundit, nuk mund ta kuptojmë se si mund të jetë bord profesional i privatizimit dhe të cilët janë ata ekspertë të privatizimit, të cilët janë ndërtuar kaq shpejt. Të paktën është dashur të jenë ekspertë të ekonomisë. Kur flasim për ekspertë, e kemi të qartë se çka mendojmë me ekspertë. Ne besojmë në Kuvendin e Kosovës.

Përfundimisht, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk do ta votojë këtë listë të propozuar për këto arsye dhe për arsye të tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Pa dashur t'i përsëris ato që i thanë para folësit e mi, me kompetencë flas se asnjëri prej këtyre anëtarëve nuk është ekspert nga fusha e privatizimit, në qoftë se e shikoni, në prizmin e ekspertizës. Në aspektin e përfaqësimit politik, respektivisht ngjyrosjes, nëse dëshiron vërtet kjo Qeveri të ngjyrosë edhe këtë Bord të Privatizimit, në profilizimin politik është forma më e mirë kjo që e ka propozuar. Mirëpo, duke marrë parasysh qëndrimet tona se Agjencioni i Privatizimit, kur kemi folur edhe për Ligjin që e kemi aprovuar ditë më parë, kemi thënë se duhet të jetë vërtet një bord jo politik, shumë profesional dhe që respekton normat e privatizimit. Ndoshta edhe i moralshëm shumë në aspektin e kredibilitetit, sepse vërtet është fjala për privatizimin e një prone që është e gjithë qytetarëve të Kosovës.

Andaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë, si Grup Parlamentar, nuk e përkrah tërësisht listën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Sadik Idriz, e ka fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedniče!

Mislim da je vlada napravila jedan korak napred u odnosu na prethodnu vladu zato što u ovom bordu nema članova vlade, ali ipak su predstavnici političkih subjekata, jedan predsednik opštine i jedan predsednik partije i član... parlamenta jesu predloženi za ovaj bord, znači što daje jednu boju toga.

S druge strane, ovo je mislim drugi put da se ispred manjinskih zajednica predlažu opet ispred Srpske zajednice. Nemamo protiv ništa znači, ali treba jednom na red da dodju i ostale zajednice. Mi ćemo podržati ovaj bord, kao i ostali, zato što smatramo da treba da postoji taj bord, da se formira i da radi, ali da se vodi računa prilikom formiranja bordova i da budu zastupljene i druge zajednice. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, shefi i Grupit Bojan Stojanoviq, e ka fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Samostalna Liberalna Stranka, tojest Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke će podržati predlog vlade jer smatramo da je vlada imala dovoljno kapaciteta da pravilno proceni ljude koji će sačinjavati ovaj bord. U svakom slučaju, vlada preuzima odgovonost za sve ono što taj bord bude uradio dobro ili eventualno da dozvoli neke nepravilnosti, tako da mi u potpunosti podržavamo i glasaćemo za ovaj bord. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kanë radhën deputetët. Urdhëroni, ministër, nëse doni të jepni ndonjë sqarim.

AHMET SHALA: Të nderuar deputetë,

Mbase ka nevojë të lexohet saktësisht deklarata e Bahri Shabanit, e cila, mbase për shkak të arsyeve të ndryshme, nuk ka arritur te secili prej jush, por thotë:

“Për Kuvendin e Republikës së Kosovës

Zotit Jakup Krasniqi, Kryetar

Nga Konfederata e Sindikatave të Lira të Kosovës, Bahri Shabani, kryetar

D E K L A R A T Ë

Me propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, jam caktuar njëri prej anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, andaj, unë Bahri Shabani, kryetar i KSLK, deklaroj se, nëse miratohet propozimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin tim...

(Ndërhyrje e deputetit)

Por, është e natyrshme mendoj.... për anëtar të Bordit të AKP pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të kryer këtë detyrë do të pushoja të gjitha aktivitetet e mia në Konfederatën e Sindikatave të Lira të Kosovës”.

Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem! Mendoj se sqarimi është më i plotë se ai në fillim. Për fjalë është lajmëruar deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti Kryeministër,

Si deputet i këtij Kuvendi, përshëndes vendimin për t’u formuar sa më parë Agjencioni Kosovar i Privatizimit për arsye se procesi i privatizimit që një kohë të gjatë në Kosovë është ndalë dhe ka pasoja negative për zhvillimet në ekonominë kosovare dhe në përgjithësi për punësim dhe në gjithë çka lidhet me procesin e privatizimit.

Më lejoni, zoti Kryetar i Kuvendit, që të shpreh mendimin tim lidhur me një njoftim që e kanë marrë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit – shefat e grupeve parlamentare, që ndaj

anëtarit të propozuar për anëtarin e pestë, zotin Bahri Shabani, është e ngritur në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë, padia e bazuar në raportin e auditimit. Pra, padi e bazuar në raportin e auditimit nga viti 2002 dhe 2006 dhe me këtë padi dhe me këtë raport, ky raport i është dorëzuar Drejtoratit për Krime të Rënda të Shërbimit Policor të Kosovës, Sektorit të Hetimeve Ekonomike dhe të Korrupsionit.

Mendoj se Qeveria nuk është dashur ta sjellë si propozim një njeri qoftë nëse ka edhe padi private, të bazuar ndoshta në ndonjë edhe artikull në gazetë, por në qoftë se ajo lëndë ekziston në prokurori, atëherë nuk është dashur të sillet si kandidat i propozuar nga Qeveria.

Zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Një parafolës tha se ka ndryshuar kjo qeveri në raport me qeverinë e kaluar. Tani nuk janë të emëruar njerëzit e qeverisë, por unë kisha për të thënë, tani të partive politike, pra është hequr ndikimi i qeverisë ndoshta mbi këtë bord, por është forcuar ndikimi i kryesive të partive që përfaqësojnë këta kandidatë.

Personalisht, si deputet i këtij Kuvendi, kisha votuar për këtë bord, duke marrë parasysh nevojën që Kosova duhet ta ketë sa më parë, po qe se do të ishte sqaruar çështja rreth anëtarit të pestë dhe nuk dua të prejjudikoj, nuk e kam ndërmend ta akuzoj zotin Bahri Shabani, por fakti se një lëndë kundër tij është në Prokurori të Qarkut të Prishtinës, më bën të tërheq votën time “pro” këtij Bordi dhe do të votoj “kundër”. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Auditor i nderuar,

Është modë që të quhet bord, esencialisht është këshill drejtues. Dikur për të qenë anëtar i këshillit, ka qenë obligim, sot është privilegj i madh, një.

Dy, “ngrirja” është një term arbitrar, konstruksion, voluntarist. Nuk ekziston kudo qoftë, në Kosovë ekziston, por është inekzistent sepse nuk përkon as me tekstin kushtetutar, as me çka do qoftë, sepse nuk mund ta ngrijë askush funksionin e vet, si të them, në mënyrë arbitrare, po e ngrij e mandej po e shkrij, e tjera, e tjera.

Prandaj, në këtë rast, kjo vlen për zotëri Shabani dhe për këndo qoftë, kudo qoftë.

Ju lutem, vërehet edhe kumulimi i funksioneve, që absolutisht është intolerant, nuk shkon në funksion të efikasitetit, eficiencës. Nuk ka nevojë. Për fatin e mirë, sot kemi edhe profesionistë, kemi edhe specialistë, kemi edhe ekspertë. Prandaj, do të duhej Qeveria t'i ketë në konsideratë këto dhe të mos propozojë njerëz të cilët ushtrojnë funksione të caktuara dhe të jenë atje.

Dhe, ju lutem, kjo që mund të jetë edhe më relevante. Zotëri Slllobodan Petroviq, nuk i plotëson kushtet sipas nenit 12 paragrafi 6 të Ligjit, ju lutem, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk i plotëson kushtet zotëri Bahri Shabani sipas nenit 12 paragrafi 2. Ju lutem, “dikta et”, rregulla e jurisë: ligji është ligj, përderisa nuk ndryshohet, na obligon të

gjithë ne dhe ne duhet ta përfillim dhe ky është obligim edhe juridik, edhe politik, edhe moral. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë, sinjerisht, ndonëse do të doja që ta kuptoja koalicionin qeveritar, por me këto propozime, sinjerisht, nuk janë kah i marrin seriozisht institucionet shumë të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës. Ngjashëm ishte me Bankën Qendrore, me ata kandidatë që nuk ishin aspak serioz.

Të bërat e AKM-së i dimë dhe në çfarë suate na ka sjellë, por megjithatë nga kualiteti i personelit që punonte aty është shumë larg nga këta njerëz të cilët janë ofruar këtu. Jo vetëm që iu mungon eksperiencia akademike, por edhe ajo praktike. Tash edhe morale, që dikush pëshpëriti atje prapa, dhe ashtu qëndron ajo. Them morale, për shkak se me këto CV është dashur atyre t'u vjen marre të konkurrojnë në hap të parë. Domethënë, fare mos të merremi me këtë, me këtë debat. Po them këtu, vetëm një kandidat sa apo mund ta shoh, ka kryer shkollim në mënyrë të rregullt në vitin 1979 deri 1985, vizavi jetës së tij, të tjerët janë shumë të dyshimtë. Domethënë, këtu dikush thotë se ka studiuar në Shqipëri në tetor të vitit 1990. Ne dimë, në tetor të vitit 1990 se çfarë sistemi ka ekzistuar atje. Pastaj, tjetër kush thotë se në vitin 1987 e kanë përfunduar për shkak të aktivitetit të tij politik nga studimet, e në anën tjetër ka qenë i punësuar nga 1985 deri 1989. Domethënë, UDB-a nuk e ka qit prej punës, por e ka qit prej fakultetit. Domethënë, janë gjëra të murgëta, të cilat thjeshtë nuk mund t'i gjellimisim.

Unë, po them, CV duhet të jetë origjinale. Me aq sa di, nëse nuk tregohen informatat e sakta, ajo është vepër penale. Ashtu, të paktën, e kuptoj unë apo si ma kanë shpjeguar në vende të organizuara mirë. Andaj, po them, me sinjeritetin më të madh, por duke pasur gjithmonë parasysh nevojën urgjente që Agjencioni Kosovari i Privatizimit të funksionalizohet dhe të fillojë punën, mirëpo kjo ofertë është shumë e zbehtë dhe është nënçmim për atë institucion që të procedohet më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Funksionalizimi i Agjencionit për Privatizim është i domosdoshëm, por suksesi dhe efienca e tij do të varet nga anëtarët e Bordit dhe vetë procesi i privatizimit.

Unë do të koncentrohem, gjithashtu, te zotëri Bahri Shabani. E dëgjova zotëri ministrin me shumë kujdes për deklaratën e zotëri Shabanit dhe ashtu, siç e lexoi ministri, thuhet se "ai do të japë dorëheqje pasi të zgjedhet". Domethënë, ai nuk ka dhënë dorëheqje dhe kjo është non-sens. Prandaj, nuk do ta votoj këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputetja Vezira Emrush, si e fundit.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala puno!

Pozdravljam sve prisutne i posebno predsjedništvo,

Danas je pred nama jedan materijal koji je jako važan i krajniji je vreme da se ovde na Kosovu ozbiljno počne sa pravom privatizacijom. Znamo sve šta je sa ovom Agencijom

uradjen u toku ovih godina. Znamo da imamo veliki društveni kapital koji treba da se transformiše u privatni kapital i mislim da pred nama nijedan od ovih navedenih kandidata ne može da ponese toliko veliki posao koji se pred njima postavlja. Zašto to mislim? Zato što su to većinom ljudi koji su radili u toj agenciji i mi svi znamo šta je to što su uradili.

Ako poverenje damo opet istim ljudima, opet ćemo da nastavimo samo isti film. Ja mislim da ovi nisu stručni ljudi i da mi jednostavno, krajnje je vreme da se ozbiljno pozabavimo kada je u pitanju faktor čovek i posebno vlada da bira prave ljude, ljude koji će jednom zauvek da počnu da rade kako treba.

Mi smo sada u fazi gde treba da postavimo ponovno preispitivanje prodatih preduzeća a u Bordu postavljamo iste ljude da guraju neke završene stvari. Moje je mišljenje, lično, ja neću da podržim ovakvu komisiju. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për diskutim. Po hyjmë në procedurë të votimit.

Unë, këtu nuk kam të lajmëruar më për diskutim dhe, nëse ka, është mirë të lajmërohen me kohë.

(Ndërhyrje)

Po, thashë, lajmërimi duhet të bëhet me kohë. Urdhëroni, merreni fjalën. Fjalën e ka Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë po e marr në kohën bash të duhur, sepse kur të hyjmë në votim nuk thuhet asgjë, ju e dini edhe sipas Rregullores, e tash erdhëm aty. Unë bëj pyetje, a do të bëhet votimi për krejt listën, a do të bëhet për secilin veç e veç, a do të tërhiqet kandidati i fundit? Kjo, për të mos folur kur të fillojë votimi, sepse kur të fillojë votimi, atëherë s'ka të folur, unë e di atë punë.

KRYETARI: Prej fillimi është ditur se në tërësi votohet lista e propozim-vendimit të Qeverisë. Ligji nuk e thotë as atë tjetrën. E ke pasur fjalën, i nderuari Ibrahim Makolli. Tani do të hyjmë në procedurë të votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Në sallë janë të pranishëm 82 deputetë.

Konstatohet se me 40 vota “për”, 22 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me këtë përbërje:

- Dino Hasanaj, kryesues,
- Fadil Ferati,
- Haxhi Arifi,
- Slobodan Petroviq, dhe
- Bahri Shabani.

Ju faleminderit! Mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti: **Njësia e Transkripteve**